
DEBATE SHKENCORE

PETRIKA THËNGJILLI**NJË VËSHTRIM KRITIK MBI PIKËPAMJET E HYSAMEDIN
FERAJT PËR SKËNDERBEUN****1. Pak histori**

Gjatë këtyre 25 vjetëve pikëpamja antiskënderbeje u gjallërua si asnjëherë tjetër. Deri tani ajo përfaqësohej nga shteti osman, tani nisi me individë, të cilët në dukje paraqiten si të pavarur. Krahas tyre, qeveria turke ka kërkuar dhe vazhdon të kërkojë rishikimin e marrëdhënieve shqiptaro-osmane të shek. XIV-XV. Ndërsa historianët kosovarë i kthyen një përgjigje të prerë se nuk ka asnjë rishikim, qeveria shqiptare pranoi të krijojë një komision të përbashkët, i cili është mjaftuar me disa aktivitete të përbashkëta, por pa asnjë rezultat. Strumbullari i rishikimit do të jetë Skënderbeu. Kam besim se askush nuk mund ta vlerësojë Skënderbeun si “mosmirënjohës, bukëshkalë, tradhtar” apo të kenë infiltruar disa teza të pikëpamjes antiskënderbeje. Ky artikull synon të tërheqë vëmendjen e shqiptarëve rreth rrezikshmërisë së kësaj pikëpamjeje, duke bërë një përmbledhje të tezave më kryesore.

Në letërsinë historike rreth figurës së Skënderbeut janë paraqitur dy pikëpamje diametralisht të kundërta.

E para, është ajo që u formua gjatë rrjedhës historike, që i ka rezistuar asaj dhe që predominon në historiografinë shqiptare dhe më gjerë. Sipas saj, Skënderbeu ishte një hero kombëtar për çka bëri sa ishte gjallë dhe me veprën e tij, pas vdekjes.

Në historiografinë protonacionale shqiptare pikëpamja skënderbeje nis me biografët e parë: M.Barleti dhe Dh. Frëngu, vazhdoi me F. Bardhin, P.Budin dhe me P.Bogdanin. Vlera e biografëve të parë është se shtruan trasenë mbi të cilën do të ngrihet ndërtesa skënderbeje. Ndonëse kanë kaluar mbi 500 vjet nga dita kur veprat e tyre panë dritën e botimit, edhe botimet e kohëve të fundit, që pretendojnë se mbështeten në një bazë të re dokumentare, nuk mund t'i përjashtojnë ato nga burimet historike. Kështu, në veprën e O.J.Schmitit mbi 14.3% e referencave e zë

historia skënderbejane e periudhës protonacionaliste, prej të cilave 9% i takojnë M.Barletit, 3.1% Dh.Frëngut dhe 2.29% kronikës së Muzakajve.¹

Figura e Skënderbeut iu paraqit Evropës si një model i bashkimit dhe i forcës së tij. Në Evropë kjo pikëpamje mori shtrirjen më të madhe. Deri në mesin e shek. XVIII vepra e M.Barletit njohu mbi 21 botime në disa nga gjuhët e Evropës², kurse vepra e Dh.Frëngut mbi 20 botime, shumica në italisht³.

Me vdekjen e Skënderbeut filloi të marrë konturet e saj pikëpamja antiskënderbejane. Armiku për të mos lënë mbi tokë dhe nën tokë, asnjë gjurmë të tij, nxori nga varri eshtrat, nuk la asnjë monument që lidhej me emrin e tij dhe u përpoq që ta mbulonte pluhuri dhe errësira. Disa të tjerë u përpoqën ta paraqisnin luftën e tij si një luftë për interesat e tij, aq sa në çastin e fundit e mallkuan se i kishte marrë në qafë, duke i hedhur në luftëra me pasoja katastrofale. Sigurisht kjo nuk kaloi pa pasoja. Lufta ishte e pamëshirëshme për të harruar gjithçka nga veprat dhe bëmat e Skënderbeut. Kronistët osmanë nga shek.XVI shtrembëruan realitetin historik, duke i kthyer disfatat në fitore ose betejat humbëse ia lanë harresës.

Pikëpamja antiskënderbejane gjatë protonacionalizmit pati pasoja të rënda negative, duke sqaruar se ajo drejtohej nga shteti osman, i cili përdori të gjitha format e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta për t'ia kaluar harresës figurën e Skënderbeut.

Megjithatë shqiptarët nuk e harruan atë, nuk e lanë që ta mbulonte pluhuri dhe errësira. Qysh nga fillimi i shek. XVII, mjaft udhëheqës janë përpjekur të bëhen një Skënderbe i dytë. Skënderbeu u bë pikë referimi me të cilin do të krahasohen figurat e mëvonshme⁴. Në vitin 1636 Frang Bardhi mbrojti origjinën shqiptare të Skënderbeut⁵.

¹ Petrika Thëngjilli, *Skënderbeu: arritje, mangësi, pikëpamje të ndryshme*, Prishtinë: 2012, f. 236.

² Kasem Biçoku, *Skënderbeu dhe Shqipëria në kohën e tij*, Tiranë: Botimpex, 2005, f. 230.

³³ L. Previzi, *Dhimitër Frangu, veprat e lavdishme të Skënderbeut*, Tiranë: Arbëria, 2007, f. 28.

⁴ Injac Zamputi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, vëll. III, Universiteti shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1978, f. 155, 301; Petrika Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit. Fusha politike*, nr. 2, Tiranë: Toena 2003, f.184; *Hylli i Dritës*, Shkodër, 1931, f. 24; Stavri Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllinjve*, Tiranë: 1964, f. 186, 242.

⁵ Petrika Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar (395-1875)*, Tiranë: Toena, 2000, f. 300.

Gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare pikëpamja skënderbejane u zhvillua në disa drejtime: Vazhdoi trajtimi shkencor i figurës dhe i periudhës së Skënderbeut, sigurisht brenda mundësive që u krijonte koha, duke u mbështetur në rezultatet e arritura gjatë periudhës proto-nacionaliste, prandaj sqarimi i vlerave të Skënderbeut nuk pati ndonjë përparim të dukshëm, por u bë mbrojtja e rezultateve të asaj historiografie.

Drejtimi i dytë ishte përdorimi i figurës së Skënderbeut në zgjidhjen e çështjes kombëtare shqiptare deri në Shpalljen e Pavarësisë dhe formimin e shtetit të pavarur shqiptar të cunguar. Së treti, figura e Skënderbeut u përdor në aktet kombëtare për të mbrojtur të drejtat kombëtare nga oreksi i disa qarqeve politike nacionaliste të monarkive ballkanike dhe të shteteve të mëdha që hidhnin gurin dhe fshihnin dorën.

Më shumë qarqet politike sesa shkencore ballkanike, si kroate, serbe, malazeze dhe greke, hodhën vështrimin mbi Skënderbeun, duke bërë përpjekje për ta paraqitur si të vetin dhe për ta përdorur në zgjidhjen e detyrave të formimit të shteteve të pavarura ballkanike. Përdorimi i figurës së Skënderbeut u bë edhe nga qarqet dhe shtetet e ndryshme për të sjellë në fronin shqiptar pasues të largët ose të rremë të Skënderbeut, gjatë fundit të shek.XIX dhe fillimit të shek.XX.

Së katërti, mbrojtja e etnicitetit shqiptar të Skënderbeut, e cila nuk u bë nga një autor, si në protonacionalizëm, por nga disa pena të forta.

Kjo luftë e gjatë me synime të qarta antiskënderbejane i dha frytet e veta. Sipas G.H.Hanit gjatë pranisë së tij në Shqipëri, ai nuk gjeti asnjë gjurmë për Skënderbeun në Shqipërinë e Mesme dhe të Veriut, aq sa rilindësit nuk kishin një ide të qartë mbi simbolet e shtetit të Skënderbeut, si flamuri, vula, etj.

Në historiografinë shqiptare skënderbejane të periudhës midis dy Luftërave Botërore u hodhën themelet e studimeve shkencore kushtuar Skënderbeut me veprat e Nolit, Xhevat Korçës dhe të Athanas Gegajt. Paralelisht me punën e mirëfilltë shkencore, vazhduan përpjekjet për përdorimin e figurës së Skënderbeut në zgjidhjen e çështjes kombëtare më 1913-1924, përdorimi i figurës së Skënderbeut nga Zogu për interesat personale, nga fashizmi italian, nga komunistët gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare⁶. Në historiografinë evropiane skënderbejane mbizotëronte vlerësimi pozitiv.

⁶ Përdorimi do të trajtohet më poshtë.

Historiografia e pas Luftës së Dytë Botërore në shtetin shqiptar, përvetësoi rezultatet e arritura deri atëherë nga historiografia skënderbejane. Trajtimi i figurës së Skënderbeut u bë sipas materializmit dialektik dhe historik, në lidhje të ngushtë të heroit me masat popullore, duke nxjerrë në plan të parë rolin vendimtar të fshatarësisë dhe zotësinë e Skënderbeut për t'u lidhur me masat, ndryshe nga homologët e tjerë. Qysh në konferencën e organizuar me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Skënderbeut me gjuhën e Ezopit u bë një përpjekje për ta cenuar këtë lidhje binomi hero-masë, me justifikim se, a do t'u kish bërë ballë populli shqiptar osmanëve nëse nuk do të udhëhiqej nga Skënderbeu? Ndonëse e pranon rolin e individit, por roli dhe suksesi i udhëheqësit varej prej disponimit të popullit⁷.

Konferenca e Dytë Albanologjike bëri përgjithësimin e parë shkencor të rezultateve të historiografisë shqiptare në nivelin kombëtar. Përfaqësuesit kryesorë janë: A.Buda, K.Frashëri, S.Pulaha, K.Biçoku, A.Luarasi. Në historiografinë shqiptare jashtë kufijve shtetërorë përfaqësuesit kryesorë janë: F. Noli, A.Ermenji, T.Zavalani, F.Hadri etj. Figura e Skënderbeut u trajtua nga dy këndvështrime: materialiste dhe idealiste. Megjithatë nga të dy këndvështrimet u arrit në përfundimin se Skënderbeu është jo vetëm hero legjendar i popullit të vet, por edhe një figurë politike me dimensione evropiane.

Gjatë periudhës së ndryshimeve demokratike, historiografia shqiptare, vazhduese e periudhës së diktaturës, u duk se ishte në një periudhë pritëse, apo reflektuese, që zgjati pothuajse një dekadë e gjysmë. Gjatë kësaj periudhe nxori kryet pikëpamja antiskënderbejane me disertacionin e H.Ferajt, mbrojtur në vitin 1996⁸. Ndonëse disertacioni i kushtohet mendimit politik shqiptar mbas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990, figura e Skënderbeut përmendet dy herë. Herën e parë pohohet se orientimi politik i Skënderbeut është vënë në dyshim dhe madje është kundërshtuar nga një pjesë e shqiptarëve që për së gjalli nga Hamzai, Dukagjini, Moisi Golemi etj., dhe ka vazhduar deri në ditët e sotme. Herën e dytë pretendohet se Skënderbeu ka qenë për bashkëpunim

⁷ Konferenca e Dytë e Studimeve Albanologjike, me rastin e 500-vjetorit të vdekjes së Gjergj Kastrioti-Skënderbeut, Tiranë 12-18 janar 1968, vëll.I, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1969, f. 229-230.

⁸ Hysamedin Feraj, *Aspekte të mendimit politik mbas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1990*, disertacion në Bibliotekën e Fakultetit të Shkencave Shoqërore të UT.

me sllavët dhe grekët dhe kundër tij kanë qenë Dukagjinasi, Hamza Kastrioti, Moisi Golemi, Ballaban Pasha.

Me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut, pikëpamja skënderbejane u bë promotori i organizimit të një varg aktiviteteve kujtimore-shkencore në Tiranë, Shkup, Prishtinë dhe në vende të ndryshme të Europës⁹.

Në mbështetje dhe në unison të H. Ferajt u vu Abdi Baleta. Ai qysh më 23 janar të vitit 2005 në gazetën “Rimëkëmbja” botoi artikullin me titull “Kush dhe pse po e nxjerr sot Skënderbeun në mejdan”¹⁰. Në artikullin që i ngjante një platforme, A. Baleta kishte kryer një rishikim përmbyesës të të gjithë veprës së Skënderbeut dhe kishte dalë kundër të gjithë trashëgimisë së mbledhur gjer atëherë. Me këtë vlerësim A. Baleta për çështjen e Skënderbeut dëshironte të fillonte një erë e re. Askush nuk e kishte bërë këtë gjë më parë, as kishte guxuar ta mendonte. Gjergj Kastriotin, heroin dhe mitin e të gjithë shqiptarëve, ai e kishte vënë me kokë poshtë, kishte rrëzuar gjithë “mbretërinë” e tij të adhurimit kombëtar. Në rast se deri atëherë bashkëkombësit e kishin mbajtur Skënderbeun në lartësi, A. Baleta në artikullin e tij të gjatë e kishte ngritur vetëm sa për ta varur në litar¹¹.

Në artikull bëhen përpjekje për të argumentuar se Skënderbeu ka bërë luftë kundër fuqisë më të madhe të kohës, kundër superfuqisë botërore. Prandaj ai mund të përdoret si shembull i luftës kundër superfuqive dhe të bëhet thirrje “hajde t’i shpallim luftë fuqisë më të madhe të kohës tonë, SHBA-ës, si Skënderbeu fuqisë më të madhe të kohës së tij. Kush është kundër kësaj politike është kundër Skënderbeut. Kështu, u përdor, për shembull nga E. Hoxha për t’u shpallur luftë dy superfuqive”¹².

Me pretekstin e paraqitjes së mendimeve të debatit, H. Feraj zgjeron dhe i pasuron mendimet e tij kundër Skënderbeut.

Skënderbeu është bashkëpunëtor me pushtuesit me këto argumente: Skënderbeu ka qenë bashkëpunues politikisht me serbët, veçanërisht me sundimtarin e Kosovës, Brankoviç, prandaj përgjigjja në këtë pyetje është e lidhur me një pyetje tjetër: a është Kosova toka shqiptare, domethënë Atdhe? Në qoftë se po, dhe ndodhet nën sundimin serb, atëherë del se

⁹ Më hollësisht shih: P. Thëngjilli, *Skënderbeu: arritje, mangësi ...*, f. 200-225.

¹⁰ *Po aty*, f. 24.

¹¹ Ylli Polovina, *Gjysma e harruar e Skënderbeut*, Tiranë: Emal, 2008, f. 24-25.

¹² *Po aty*, f. 25.

bashkëpunimi me serbët ishte bashkëpunim me pushtuesit e atdheut. Në qoftë se Kosova nga udhëheqësit shqiptarë nuk konsiderohet tokë shqiptare, pjesë e atdheut, atëherë bashkëpunimi me serbët nuk është bashkëpunim me pushtuesit e atdheut, por vetë politikani shqiptar sillet dhe mendon njësoj si politikani serb, d.m.th. jo si bashkëpunëtor i serbëve, por si vetë serbët, sepse konsiderimi i Kosovës tokë joshqiptare është karakteristikë themelore e mendimit të çdo politikani serb. Në të dy rastet, bashkëpunimi i Skënderbeut me serbët tregon rreshtimin e tij në anën e pushtuesve, përkatësisht të armiqve të shqiptarëve.

Sipas tij për shqiptarët rreziku kryesor, sundimtarë dhe pushtues më të rrezikshëm, mbetën sllavët dhe grekët. Prandaj të gjithë politikanët shqiptarë zgjodhën ndërmjet rrezikut më të madh dhe rrezikut më të vogël dhe jo ndërmjet lirisë dhe robërisë, zgjodhën bashkëpunimin me armikun dhe pushtuesin më pak të rrezikshëm osman, ose me armikun dhe pushtuesin më të rrezikshëm sllav e grek. Bashkëpunimi i Skënderbeut me serbët dhe grekët tregon se ai ka qenë bashkëpunëtor me armiqtë dhe pushtuesit më të rrezikshëm sllavë dhe grekë.

Me bashkëpunimin e tij me serbët dhe grekët, Skënderbeu ndikoi në krijimin e një tradite të bashkëpunimit të politikanëve të mëvonshëm shqiptarë me politikanët serbë dhe grekë kundër armikut të “përbashkët”, që përgjithësisht përfundoi në humbje të shqiptarëve, në kuptimin e nënshtrimit të politikës shqiptare ndaj asaj serbe dhe greke, që mbetën armiqtësore; se përpjekjet për të ndarë konceptin “miqësi” mes politikanësh të popujve të ndryshëm nuk ka vlerë, sepse ajo që quhet “miqësi” mes popujve, në fakt është miqësi ose bashkëpunim midis politikanëve.

Sipas tij, nga historianët zyrtarë të 50 viteve të fundit figura e Skënderbeut është përdorur ndër të tjera edhe për të treguar se ndërmjet shqiptarëve e serbëve ka patur miqësi shekullore që është kalitur në fushën e luftërave të përbashkëta kundër të njëjtit armik etj. Veç këtyre, Skënderbeu mund të përdoret dhe është përdorur për të nxitur intolerancën fetare ndërmjet shqiptarëve, për të nxitur përçarje dhe konflikte politike ndërmjet shqiptarëve etj, etj. Por nga përdorimi më tepër gjykohen prirjet politike të përdorimeve se sa vetë Skënderbeu.

Sipas autorit të pikëpamjes, arsyet e armiqtësisë së dukagjinase ndaj Skënderbeut duhen kërkuar në qëndrimin miqtësor të Skënderbeut ndaj Brakonviçit, armikut më të madh të shqiptarëve të Kosovës. Sipas pikëpamjes vasaliste, miqtësia me popujt e Ballkanit “ka qenë arsye e

armiqësimit në radhët e shqiptarëve, sepse ata shqiptarë që vuanin nga sundimi serb me të cilët bashkëpunonte Skënderbeu, e shikonin me revoltë vetë këtë udhëheqës dhe shqiptarët që e mbështesnin”. Prirjet e Skënderbeut për miqësi dhe aleanca politike përveç me sundimtarin serb të Bosnjës edhe me sundimtarin serb të Kosovës, despotin Gj. Brankoviçi, ka qenë shkak i armiqësive të popullsisë shqiptare që vuante terror nën sundimin e Brankoviçit ndaj Skënderbeut¹³.

Pas shekujsh sundimi, si serbët, si osmanët, përjetoheshin si pushtues dhe sundimtarë. Nga bashkëpunimi me serbët Skënderbeu nuk del shembull i luftëtarit për liri dhe pavarësi, por i bashkëpunimit me njërin nga pushtuesit (serbët) në luftë kundër pushtuesit tjetër (osman). Për të treguar se Skënderbeu nuk ka qenë shëmbëlltë e luftëtarit të lirisë, autori i mëshon faktit se Skënderbeu ishte vasal i Venedikut dhe jo i sulltanit, vasal i një sundimtari pushtues¹⁴.

Gatishmërinë dhe përpjekjet e Skënderbeut për të bashkëpunuar me udhëheqësit politikë serbë dhe grekë, sipas autorit, nuk e kanë bërë politikën serbe e greke miqësore ndaj shqiptarëve në asnjë periudhë dhe për asnjë ngjarje.¹⁵ H. Feraj pretendon se në pikëpamje praktike, shqiptarët me gjithë figurat e paraqitura si heroike, që kanë bërë zgjedhje të drejta e luftëra heroike, gjenden në situatë më të keqe se të gjithë popujt e tjerë.

Sipas tij, vënia në dukje e rolit mbrojtës së Evropës është bërë për përfitime politike. Duke e paraqitur Skënderbeun si mbrojtës i krishterimit, shqiptarët fitojnë përkrahjen politike të kristianëve për interesat e kohës, pavarësisht nga rrjedhojat që ka sjellë, veprimtaria e Skënderbeut dhe figura e tij duhet të ruhet për shkak të frymëzimit që jep tek shqiptarët për luftën për liri dhe për pavarësi.

H. Feraj gjykon se Papat, Venediku e kanë përdorur Skënderbeun për të dobësuar rrezikun osman ndaj tyre, duke zhvilluar luftërat e tyre në territorin shqiptar. Duke e konceptuar si politikan, këto fuqi kanë arritur ta fusin Skënderbeun në luftë kundër superfuqisë më të madhe të kohës, ose sikur t'i shpallë Shqipëria luftë SHBA. Gjatë një çerek shekulli shqiptarët nuk kanë mbjellë e nuk kanë korrur, nuk kanë zhvilluar zejet e tregtinë, etj. Është shkatërruar një pjesë e madhe e popullsisë, e pasurive,

¹³ H. Feraj, “Mbi debatin për Skënderbeun”, në gazetën *Rimëkëmbja*, 1 shkurt 2000.

¹⁴ Po aty.

¹⁵ Po aty.

si ullishte, vreshta etj., etj. Nga të gjitha këto, nga kjo politikë e Skënderbeut mund të kenë përfituar popujt e ndryshëm, por kanë humbur shqiptarët. Megjithë premtimin për të mos bërë degresione, degëzimet e argumentimit, këtu bëhet i nevojshëm një i tillë. Fjala është për argumentin se ndërmjet punës së Skënderbeut drejt katolicizmit dhe prirjes drejt sllavizmit dhe ortodoksisë, ka një kontradiksion të papajtueshëm së paku në kontekstin e marrëdhënieve ndërmjet katolicizmit shqiptar dhe sllavëve ortodoksë, në radhë të parë, serbëve. Në traditën katolike shqiptare ka pasur një rrymë të fortë të konfliktit me ortodoksizmin serb që kur u ndanë kishat në romake dhe bizantine. Në kohën e Skënderbeut ende ishin të pathara damkat e hekurit të skuqur të pushtetit serb të Stefan Dushanit, shpronësimet, ndarjet e fëmijëve nga nënat, për konvertimin e shqiptarëve katolikë në ortodoksë. Këto janë tregues edhe i shkallës së lartë të kundërshtimit të shqiptarëve katolikë për t'u kthyer në ortodoksë, që e bënë të nevojshme përdorimin e mjeteve ekstreme mesjetare të dhunës. Sipas tij, prirja e Skënderbeut për aleanca me nipin e car Lazarit, Brankoviçin, ishte krejt në kundërshtim me këtë qëndresë popullore dhe me rrymën e klerit katolik shqiptar. Afrimi drejt sllavizimit dhe ortodoksisë është në kundërshtim me qëndresën popullore dhe të klerit katolik shqiptar kundër ortodoksizmit sllav, sepse nuk mund të ishte njëkohësisht edhe mik i sllavëve edhe mbrojtës i katolicizmit shqiptar.

H.Feraj zgjeron më tej tezat e paraqitura në skicë, si orientimi i familjeve shqiptare në bizantinofilë dhe serbofilë¹⁶, ngjitja e shkallëve të hierarkisë shtetërore osmane u bë për arsye etnike dhe si një sistem më i lehtë.¹⁷, ndarja e shoqërisë në “Skënderbegas” dhe “vasalistë”¹⁸. Duke mos pranuar pozitën e vasalitetit ndaj sulltanit, i propozuar nga ky i fundit, Skënderbeu ndikoi në krijimin e një tradite të bashkëpunimit të politikanëve të mëvonshëm shqiptarë me politikanët serbë dhe grekë kundër armikut të “përbashkët”, që përgjithësisht përfundoi në humbje të shqiptarëve në kuptimin e nënshtrimit të politikës shqiptare ndaj asaj serbe dhe greke, që mbetën armiqtësore¹⁹. Pala vasaliste mbron pikëpamjen e saj duke e ilustruar miqësinë dhe admirimin për Skënderbeun me këngët popullore që i kanë kushtuar popujt e Ballkanit

¹⁶ Hysamedin Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 33.

¹⁷ *Po aty*, f. 34-35.

¹⁸ *Po aty*, f. 35-36.

¹⁹ H. Feraj, “Mbi debatin për Skënderbeun ...”, 1 shkurt 2000.

dhe në vlerësimin që i bënin udhëheqësit ballkanikë rolit të Skënderbeut në planet e tyre politike²⁰.

Autori shtron pyetjet se a kishte rrugë tjetër për pushtimin e Europës? Pse nuk e pushtoi pas vdekjes së Skënderbeut? Se a duhej të mbrohej qytetërimi dhe kultura perëndimore dhe kultura e asaj kohe me justifikimin se qytetërimi dhe kultura evropiane e asaj periudhe dhe shumë më pas, ishin ndër të tjera, qytetërimi dhe kultura e kryqëzatave, inkuizicionit, djegies së rreth 700 000 plakave të pafajshme të akuzuara si shtriga, e shfarosjes së hebrenjve etj., kur vetë evropianët kishin filluar dhe pas vdekjes së Skënderbeut, i kishin shpallur luftë qytetërimin dhe kulturës së deriatëhershme evropiane, elementëve thelbësore të mesjetës të cilën e quanin periudhë të “vdekjes” dhe përpiqeshin ta zëvendësonin me “Rilindjen”, periudhë dehumanizmi dhe përpiqeshin ta zëvendësonin me humanizmin, periudhë të errësirës, dhe flakjen e saj, e quajtën periudhë të ndriçimit (iluminizmit)²¹.

Autori bën objekt diskutimi orientimin fetar të familjes së Kastriotëve në përgjithësi dhe të Skënderbeut në veçanti, të lidhjeve të tij me krishterimin perëndimor dhe atë katolik, se Skënderbeu mund të interpretohet si udhëheqës shqiptar që përftoi fillimin e luftërave fetare ndërmjet tyre.

Themeluesit e kësaj pikëpamjeje pretendojnë se Skënderbeu nuk ka frymëzuar ngjarjet e mëdha, si Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, Kryengritjen e Përgjithshme të vitit 1912 etj.

2. Teoria Zero

Pasi dhamë tablonë e mendimeve të shprehura para nesh për pikëpamjen antiskënderbejane, po japim mendimin tonë.²² Viti 2005 shënoi një varg botimesh monografish, si K.Frashëri, K.Biçoku, Y.Polovina, të shoqëruara me një sërë aktiviteteve shkencore-përkujtimore me rastin e 600-vjetorit të lindjes së Skënderbeut. Disa nga botimet janë rezultat i një punë të gjatë që kishte filluar para ndryshimeve politike dhe ishin kurorëzimi i asaj pune shkencore.

Pikëpamja antiskënderbejane është e mbuluar me një mbulesë nacionale dhe synon jo vetëm të tregojë se krahas rrymës së luftës në

²⁰ Po aty.

²¹ Po aty.

²² P. Thëngjilli, “Rreth pikëpamjeve ...”, në *Gjergj Kastrioti*, f. 37-83.

bashkëpunim me popujt fqinjë ballkanas, ka edhe një rrymë tjetër ajo e vasalitetit dhe e bashkëpunimit me armikun jashtëballkanik (osmanët), si më pak e rrezikshme se ajo e bashkëpunimit me popujt fqinj. Pikëpamja ka si synim kryesor zëvendësimin e rrymës së parë me rrymën e dytë në kuadrin e rishikimit të historisë. Këndvështrimi i kësaj rryme i ngjan “teorisë zero” që disa politikanë e trumbetuan gjatë periudhës së tranzicionit, mbasi që të ndërtohej godina e re duhej të shembej godina e vjetër dhe të hapej një shesh pushimi mbi të cilin do të ngrihej godina e re. Sikur të zbatohet kjo teori në fushën e historisë atëherë çdo gjë do të fillonte nga zero. Heronjtë dhe figurat historike do të zëvendësonin njëri-tjetrin.

Të gjithë jemi për rishikimin e historisë së periudhës së diktaturës komuniste, duke e pastruar figurën e Skënderbeut nga ato mbivlerësime të asaj periudhe, si mbivlerësimi i rolit të masave në bëmat e Skënderbeut, raportet e tij me faktorin ndërkombëtar në përgjithësi dhe atë katolik në veçanti etj. Atë që kërkon ta bëjë autori e ka bërë vetë historia, duke nxjerrë si jashtëqitje të gjitha deformimet e çdo periudhe.

Figura e Skënderbeut në “Skicën e mendimit politik” zë një faqe, me fjalë të tjera vendi është i pallogaritshëm²³. Duke u nisur nga qëllimet që përdoret figura e Skënderbeut, të krijohet bindja se kjo pikëpamje i ngjan “qemanes së Nastradinit që në mes të ditës po sharronte drynin e një dyqani, por zhurmën do t’ia ndjenin të nesërmen”. Ajo synon të rrëzojë figurën e Skënderbeut dhe pas tij, gjithë mendimin politik deri në vitet ’90 të shekullit të kaluar.

Sipas tij, specialistët kanë heshtur dhe heshtjen ai e vlerëson si një qëndrim miratues, kurse në të vërtetë heshtja në disa raste është përgjigjja më e mirë për ta harruar sa më shpejt, por shtjellimi i tyre gjatë debatit²⁴, më shtyn të shpreh mendimet rreth kësaj pikëpamje.

Skica mbështetet në disa kritere logjike dhe pretendon karakterin shkencor. Defekti më i madh i studimit është se mbështetet në mjaft raste në burime të njëanshme dhe në autorë që sa vjen dhe po e humbin reputacionin që kanë pasur më parë²⁵.

²³ H. Feraj, “Mbi debatin mbi Skënderbeun ...”, 22 shkurt 2000.

²⁴ Po aty.

²⁵ Burime të tipit se “Muhameti dhe krishti kanë folur shqip”, se shqipja është gjuha e parë prej nga kanë dalë gjuhët e tjera”, se shumë toponime shpjegohen me gjuhën shqipe, si: Gadishulli Apenin lidhet me fjalën e gjuhës shqipe “hapu”, Balltik me fjalën baltë etj.

Së dyti, autori mbështetet gjatë arsyetimit në gjymtyrë të njëanshme që të çojnë në përfundime të gabuara.

Së treti, përdoren disa klishe që u ngjajnë më tepër luftës së klasave dhe trajtimit bardhë e zi të figurave historike, zëvendësimin e heronjve me viktima, të vlerave me antivlera etj.

Pikëpamja ka mjaft teza të diskutueshme. Do të ndalemi në disa prej tyre, që nuk janë trajtuar nga autorë të tjerë ose sa janë cekur.

Le ta nisim nga orientimi i familjeve të mëdha shqiptare dhe ndarjen e tyre në “serbofile dhe bizantinofile”. Rreth strukturës shoqërore të shoqërisë shqiptare gjatë mesjetës janë bërë mjaft konstatime nga studiues vendas dhe të huaj. Padyshim që nga botimi i parë i *Historisë së Shqipërisë* (1959) e deri në botimin e fundit të vitit 2002, është bërë një evoluim i madh rreth përcaktimit të shoqërisë shqiptare, duke u shkëputur nga kallëpet shabllone dhe ato ballkanike, dhe duke iu afruar sa më shumë realitetit shqiptar dhe i mbështetur sa më fort në të. Kjo vihet re nga një krahasim i teksteve të *Historisë së Popullit Shqiptar*.

Sipas tij, dalja në skenë e feudalëve vendas mund të interpretohet si rrjedhim i pushtimeve të huaja që sunduan në këtë rajon për shekuj me radhë²⁶; krerët feudalë shqiptarë mund të thuhet se janë produkt i marrëdhënieve ekonomike, sociale dhe politike të imponuara prej pushtimeve të gjata të Shqipërisë²⁷.

Unë do ta shikoja nga një prizëm tjetër. Feudalizmi në Shqipëri, ashtu si në vendet e tjera, është një fenomen, që karakterizon një periudhë të caktuar të Mesjetës. Me fjalë të tjera lindja e marrëdhënieve feudale do të ndodhte në Shqipëri mbasi nuk ka vend në Europë që të mos ketë kaluar shoqërinë feudale. Në kushtet e sundimit të huaj: bizantin, bullgar, serb apo perëndimor, marrëdhëniet feudale do të fitonin disa veçori që lidheshin me ato pushtime. Kjo duket në disa drejtime. Në hierarkinë shqiptare ndeshen tituj bizantinë²⁸, tituj perëndimorë²⁹, tituj sllavë³⁰. Në zonat e brendshme të tokave shqiptare thelloheshin tiparet e feudalizmit lindor dhe kryesisht bizantin, kurse në zonën bregdetare ndeshen

²⁶ *Po aty*, f. 37.

²⁷ *Po aty*, f. 42.

²⁸ Despot, sebrastojrator, sebast, heteriark, protokathimen, kabalaris, qefali, etj.

²⁹ Kapiten, judex, miles, kastelan mareskaik, protontin, admiral etj.

³⁰ Zhupan, kasnec, vojvodë etj., në *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll.I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 328.

institucione të feudalizmit perëndimor, si feudi, vasaliteti, betimi, mbrojtja feudale, imuniteti etj³¹. Këtë mendim do ta ilustroja vetëm me institucionin e Pronies. Ndonëse pronia ishte tipike bizantine, e lidhur me fije të shumta me feudalizmin lindor, në tokat shqiptare ndryshonte nga ajo bizantine, ndonëse kishte ruajtur guaskën apo emrin e saj.

Po ky autor ka sajuar të ashtuquajturën “Ndarja e parë ideologjike “albanë” dhe “sllavo-grekë”. Sipas tij, gjatë shek V-VI Iliriku iu nënshtrua shkatërrimeve të mëdha të shkaktuara nga dyndja e popujve të ndryshëm, si: gotët, hunët, avaro-sllavët, se fiset avaro-sllave arritën të ndryshonin strukturën etnike në një pjesë të rëndësishme të territoreve, në të cilat u dyndën. Në qoftë se deri tani sundimi romak dhe ai bizantin, ishin kryesisht politik, ekonomik e deri diku edhe kulturor, por asnjëherë nuk ishin zhvendosje masive popujsh dhe etnish. Sllavët kishin ardhur për t’u vendosur përgjithmonë. Në shek. VIII filloi “lufta kundër ikonave”, e cila i detyronte shqiptarët t’i shkëpusnin lidhjet me papët e Romës dhe kërkonin vendosjen e kishës ilire³². Në lidhje me Luftën e ikonave dhe shqiptarët kanë një gabim të madh historik. Lufta e ikonave (ikonoklazma) ishte një tërësi masash që synonin të shkatërronin kultin e ikonave, prishjen dhe zhdukjen e tyre. Ajo lindi në fillim si një lëvizje e popullit të thjeshtë, por në të morën pjesë grupe dhe shtresa të ndryshme, me synime politike, sociale dhe kulturore³³. Me fjalë të tjera ajo as që kishte lidhje direkte me Shqipërinë, madje në asnjë dokument nuk iu kërkuar shqiptarëve të shkëpusnin lidhjet me Papatin dhe vendosjen e kishës ilire, kur as që mund të imagjinohej një gjë e tillë. Me të drejtë edhe në botimet më të fundit, pranohet se lufta e ikonave në trevat shqiptare nuk mori format e ashpra që pati në pjesët e tjera të Perandorisë Bizantine. Perandori ikonoklast Leoni III i shkëputi peshkopatat kishtarë të pjesës perëndimore që vazhdonin të vareshin nga juridiksioni i Papës së Romës dhe i vuri në varësinë e drejtpërdrejtë të Patrikanës së Konstandinopolit (732)³⁴.

Autori i jep një rëndësi më të madhe sllavëve se sa në të vërtetë. Sipas tij, nën vartësinë e Patrikanës së Konstandinopolit ky presion

³¹ *Po aty*, f. 211.

³² H. Feraj, *Aspekte të mendimit politik ...*, f. 31-32.

³³ Më hollësisht shih P.Thëngjilli-S.Daci, *Historia e Perandorisë Bizantine (395-1453)*, Tiranë: Extra, 2004, f.107-108.

³⁴ *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll. I, f. 217; G. Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine*, Tiranë: Dituria, 1997, f. 119.

sllavo-greko-bizantin mbi elementin etnik vendas u shtua edhe më shumë³⁵. Më tej ai shkruan se ndër masat e marra nga Perandoria Bizantine për të favorizuar elementin sllav krijoi një gjuhë kishtare sllave, kishën sllave, e cila rriste aftësinë asimiluese të sllavëve ndaj elementit vendas. Me të drejtë pyesim çfarë pozitë kishin sllavët në pushtetin qendror bizantin deri në shek. X?

Dihet se rusët ishin shfaqur përpara mureve të Konstandinopolit qysh në vitin 860. Për të larguar rrezikun rus, patriku i madh i Bizantit kishte menduar krishterimin e tyre dhe përfshirjen në sferën e ndikimit bizantin. Në konvertimin e tyre merita kanë vëllezërit nga Selaniku: Konstandini dhe Metodi dhe patriku Foti. Konstandini krijoi një alfabet dhe përktheu në sllavisht Shkrimin e Shenjtë. Veprën e tij e vazhdoi Cirili dhe Metodi³⁶. Literatura historike e mbështetur në një dokument të pasur bashkëkohor flet për të kundërtën e mendimeve të H.Ferajt.

I pavërtetë është edhe mendimi tjetër se në shek. XI, me ndarjen e krishterimit në dy kisha, filloi ndarja e madhe ideore, fetare e politike e ilirëve me rrjedhoja dhe vijimësi deri në ditët e sotme të shqiptarët. Ilirët të cilët i mbetën besnikë Papatit, d.m.th. ithtarët e Kishës Katolike Shqiptare, veten e quanin gjithnjë e më shpesh albanë, kurse ata që i mbetën besnikë Patrikanës së Konstandinopolit, e cila si gjuhë kishtare përdorte “greqishten e “sllavishten”, vazhdonin ta quanin veten ilirë dhe më vonë grekë e sllavë³⁷.

Asnjëherë të dy zonat nuk kanë qenë të prera si me thikë. Gjatë trajtimit të emrit nacional të shqiptarëve gjatë Mesjetës, kemi treguar se ai ishte i njëjtë, si për shqiptarët që i vazhduan lidhjet fetare me Papatin, ashtu edhe shqiptarët e ritit ortodoks. Turqit i njihnin shqiptarët me të njëjtin emër. Gjuhëtarët kanë shpjeguar se ndryshimi fillon tek zëvendësimi i “arbër” me “alban”³⁸.

Po kaq i gabuar është përfundimi që ka nxjerrë nga kjo ndarje. Sipas tij, prirja e parë “krijoi” më vonë rrymën politike nacionaliste, ndërsa prirja e dytë, format e ndryshme të rrymave sllavomane dhe grekomane

³⁵ *Po aty*, f.32.

³⁶ G. Ostrogorski, *Historia e Perandorisë Bizantine ...*, f.161-162; P.Thëngjilli-S.Daci, *Historia e Perandorisë Bizantine ...*, f. 127-128.

³⁷ H. Feraj, *Aspekte të mendimit politik ...*, f. 32.

³⁸ Më hollësisht shih P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, *Fusha politike nr. 1*, f. 223-323.

brenda kombit shqiptar³⁹. Këtu po tërheqim vëmendjen se themeluesit e nacionalizmit shqiptar, përfaqësojnë si shqiptarët e ritit katolik, ortodoks dhe më shumë nga përkatësia myslimane.

Në fund të punimit H.Feraj arrin në disa përfundime në formën e një rezymeje: Shqiptarët gjatë mijëvjeçarit të fundit nuk janë ndodhur pothuajse asnjëherë në pozitën të zgjedhin politikisht ndërmjet lirisë dhe pushtimit, por të zgjedhin ndërmjet pushtuesve më të rrezikshëm dhe më pak të rrezikshëm në shek. X-XIV ndërmjet pushtuesve bizantinë, sllavë dhe grekë apo pushtuesve të ndryshëm perëndimorë si normanët etj., ndërmjet kishës lindore apo kishës perëndimore; në shek. XIV-XX ndërmjet pushtuesve dhe asimiluesve të dhunshëm sllavë e grekë apo pushtuesve më pak asimiluesve osmanë; në Luftën e Dytë Botërore ndërmjet pushtuesve sllavë dhe grekë apo pushtuesve nazifashistë italianë dhe gjermanë. Shkurt të zgjedhin ndërmjet pushtuesve ballkanikë që rrezikonin ekzistencën e shqiptarëve apo pushtuesve jashtëballkanikë, të cilët nuk e rrezikonin ekzistencën e shqiptarëve sado të këqija të tjera, që u shkaktonin⁴⁰.

Ky konkluzion i mohon popullit shqiptar dhe ato pak vite lirie dhe pavarësie që ka shijuar gjatë rrjedhës historike, që fillojnë nga mijëvjeçari i parë i periudhës pas Krishtit, kur tokat shqiptare brenda shtetit bizantin, gëzonin një autonomi lokale në formën e “ispolitisë”⁴¹, vazhdoi gjatë Principatës së Arbërit (shek. XII-XIII)⁴², Mbretërisë së Arbërit gjatë anzhuinëve⁴³, gjatë principatave të shek. XIV, gjatë shtetit të Skënderbeut, gjatë Pashallëqeve të Mëdha Shqiptare, e periudhës midis dy Luftërave të mëdha Botërore, periudhës 1945-deri më sot.

Siç shihet shqiptari ka luftuar për liri dhe në shumicën e rasteve nuk ia ka arritur qëllimit, por në periudhat e lartpërmendura ka shijuar dhe lirinë, ndonëse jo të plotë dhe me shumë mundime. Në radhë të parë, ky

³⁹ H. Feraj, *Aspekte të mendimit politik ...*, f. 33.

⁴⁰ *Po aty*, f. 107.

⁴¹ Pëllumb Xhufi, *Dilemat e Arbërit - Një studim mbi Shqipërinë e shek. XI-XVI*, Tiranë: Pegi, 2006, f. 53; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 215-216; Aleks Buda, *Shkrime historike*, vëll. I, Lashtësia dhe Mesjeta para shek. XV, Tiranë: 8 Nëntori, 1987, f. 60.

⁴² A. Buda, *Shkrime historike ...*, vëll. I, f. 68; P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 57; *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 227-235.

⁴³ P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 167-172; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, f. 239.

mendim bie ndesh me projektet dhe kryengritjet e shqiptarëve për t'i kthyer vendit kohën e Skënderbeut⁴⁴.

Sipas tij dhe mbështetësve të tij, shqiptarët gjatë sundimit romak, bizantin dhe atij osman nuk kanë qenë të pushtuar, por bashkëqeverisës, duke u kapur tek perandorët që nxori Iliria në kapërcyellin e mijëvjeçarëve; tek perandorët që i dhanë shtetit bizantin, aq sa ndonjëri Perandorinë Bizantine e quan si Perandori e ilirëve; duke përfunduar tek mbi 33 vezirët e mëdhenj: vezirë e qindra komandantë, që nxori Shqipëria gjatë sundimit osman.

Nga përfundimi i gabuar kalohet në një gabim tjetër, që bie ndesh me realitetin. Sipas tij, nga zgjedhja që kanë bërë ndaj këtyre dy alternativave janë krijuar dy tradita politiko-themelore shqiptare:

1. Tradita e bashkëpunimit me popujt pushtues dhe rrezikues ekzistencial ballkanikë të shqiptarëve kundër pushtuesve jashtë-ballkanikë.

2. Tradita e bashkëpunimit me pushtuesit jashtëballkanikë që nuk rrezikonin ekzistencën e shqiptarëve kundër pushtuesve dhe rrezikuesve ekzistencialë ballkanikë⁴⁵. Këto tradita kanë qenë në luftë shekullore, herë të ashpër dhe të armatosur e herë intrigash dhe kurthesh politike, ndaj njëra-tjetrës. Brenda tyre janë zhvilluar rryma dhe nënrryma politike me motive të vërteta ose thjesht veshje të ndryshme ideologjike sipas kushteve e rrethanave konkrete, por që të gjitha në fund të fundit, përfshihen në kallëpet e njëres prej këtyre traditave. Rrymat politike të së njëjtës traditë shpesh janë ndodhur në luftë edhe me njëra-tjetrën, por kjo ka qenë “luftë brenda llojit”, po të huazohet një term darvinian, e cila megjithatë nuk ka çuar në aleanca të qëndrueshme me rrymat e traditës tjetër⁴⁶.

Sipas tij gjatë shek. XI-XIV shqiptarët u ndanë në rrymën që përvetësoi besnikërinë ndaj Kishës Lindore, ortodokse, sllave dhe greke dhe që e quajtën veten përkatësisht “sllavë” ose grekë” dhe rrymën që i qëndroi besnike kishës perëndimore dhe që e quante veten “albanë”. Politikisht u ndanë në rrymën e shqiptarëve që ishin besnikë ndaj “pushtimeve ballkanike” Perandorisë Bizantine, përkatësisht Mbretërive

⁴⁴ I. Zamputi, *Dokumente për historinë e Shqipërisë*, vëll.II, (shek. VIII-XV), Universiteti shtetëror i Tiranës, Tiranë: 1962, f. 271-275; P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, vëll. II, f. 151.

⁴⁵ H. Feraj, *Aspekte të mendimit politik ...*, f. 107.

⁴⁶ *Po aty*, f.108.

serbe bullgare dhe greke, të cilët bënë karrierë dhe ngjitën shkallën më të lartë të hierarkisë ushtarake e civile feudale të tyre deri në strategë dhe në rrymën që lidhej me mbretëri dhe principata të ndryshme të Europës Perëndimore kundër pushtuesve bizantinë, serbë, grekë e bullgarë.

Në Mesjetën Shqiptare nuk mund të flitet për dy rryma kryesore me tipare të qarta të kundërta me njëra-tjetrën sepse nuk kishim një zhvillim të tillë të marrëdhënieve feudale apo kapitaliste sa të kristalizoheshin këto dy rryma. Sa për ilustrim po japim një shembull. Nga fillimi i shek. XVII Senati i Venedikut u shqetësua nga lajmi se në Shqipëri po përgatitej një kryengritje e përgjithshme, prandaj kërkoi nga njerëzit e vet në Shqipëri, të njoftojnë në se ishte i vërtetë ky lajm. Ata e këshilluan senatin “që të rrijë i qetë sepse nuk ka për të ndodhur gjë, mbasi një pjesë e shqiptarëve ishin lidhur me Venedikun dhe do të vepronin sipas këshillave të tij; një pjesë tjetër ishte lidhur me Romën dhe do të vepronin sipas këshillës së Papës; të tretët ishin lidhur me qeverinë spanjolle dhe do të vepronin sipas udhëzimeve të saj dhe një pjesë ishin lidhur me osmanët. Nuk ka burrë që t’i vërë në emërues të përbashkët shqiptarët”- përfundonin këshillat⁴⁷.

Jo vetëm që nuk ka pasur rryma por as një familje e madhe shqiptare nuk mbajti një orientim me ndryshimin e situatave politike sepse përndryshe do të kryenin veprime donkishoteske.

Prej kohësh historiografia shqiptare ka theksuar karakterin shqiptar të këtyre familjeve të mëdha. Kjo është argumentuar edhe më mirë kohët e fundit në disa punime kolektive dhe monografi⁴⁸. Megjithatë në letërsinë historike të kohëve të fundit, të mbështetur në studime të 60 vjetëve më parë, po vihet në pikëpyetje karakteri shqiptar i këtyre familjeve feudale. Kështu, autorja turke N.Bozbora është e mendimit se është e vështirë të japësh gjykim të prerë mbi identitetin kombëtar të familjeve si Topiajt, Muzakajt apo Dukagjinët. Ajo ka të drejtë kur

⁴⁷ P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, vëll. II, f.179.

⁴⁸ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 208, 216; P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 79, 88; K. Biçoku, *Skënderbeu dhe Shqipëria ...*, f. 41-47; Kasem Biçoku, *Për Skënderbeun*, Tiranë: Botimpex, 2005, f. 368-396; Luan Maltezi, “Dukagjinët dhe Skënderbeu”, në *Skënderbeu dhe Evropa (përmbledhje kumtesash)*, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 2006, f. 83-102; F. Duka, “Tokat e Kastriotëve: zona Krujë-Dibër (shek. XV-gjysma e parë e shek. XVI), në *Skënderbeu dhe Evropa ...*, f. 34-47.

shqiptari Hasan Kaleshi ka shkruar se shumica e këtyre familjeve janë me origjinë të huaj, qoftë nga emri, qoftë dhe gjuha⁴⁹.

H.Feraj përpiket t'i ndajë familjet e mëdha shqiptare në bizantinofile dhe serbofile⁵⁰. Sipas tij, gjatë sundimit njëmijëvjeçar bizantin, serb dhe bullgar, etj., fisnikët shqiptarë ishin të përcarë dhe të lidhur me pushtuesit e ndryshëm. Disa prej tyre për shërbimet e larta në të mirë të pushtuesve bizantinë, kishin arritur edhe shkallët më të larta të hierarkisë ushtarake dhe administrative deri në strategë. Në shek. X-XIV dalloheshin për besnikëri dhe shërbime ndaj pushtuesve bizantinë, veçanërisht familje të tilla, si Arianitët, Muzakajt, Topiajt, princat e Arbërit etj. Me bullgarët kishin krijuar lidhje të veçanta rivale të bizantinëve, si Gjon Vladimiri, Gjon Krisili etj. Nga fundi i shek. XIV, me gjithë luftërat e mëparshme kundër car Dushanit, me serbët kishin filluar të krijojnë lidhje politike e familjare edhe Balshajt dhe në mënyrë të veçantë këto lidhje i kishin të hershme Kastriotët etj⁵¹.

Cilësimi dhe klasifikimi i tyre si “bizantinofilë” etj., bazohet në orientimin e tyre më të qëndrueshëm në kuptimin sasiar-kohor dhe cilësisht më të qartë të shprehur në shkallën e lartë të besueshmërisë së pushtetit qendror bizantin ndaj tyre, titujve të lartë ushtarakë-administrativë, që mbartnin dhe nga i cili vepronin politikisht⁵². Autori justifikohet se ky klasifikim bazohet në përshkrimin e historisë së kësaj periudhe nga *Historia e Shqipërisë*, Tiranë, 1967; *Historia e Popullit Shqiptar për shkollat e mesme*, Tiranë, 1994 dhe Fjalori Enciklopedik Shqiptar tek zërat e familjeve të mëdha⁵³.

Nga mbështetja burimore duket se veprimi është tendencioz dhe me qëllim denigrues. Disa nga familjet kanë etikën serbofile. Sikur të mos kishte ndodhur asgjë pak më poshtë, ai e pranon se megjithatë aleancat nuk ishin të qëndrueshme dhe në periudha të ndryshme, ndryshonin edhe ato. Kështu, për familjet e cilësuar si “antibizantine” dokumentohen raste të bashkëpunimit me bizantinët dhe për familjet e cilësuar si “Bizantinofile”, dokumentohen konflikte dhe madje luftëra të zhvilluara

⁴⁹ Nuray Bozbor, *Shqipëria dhe nacionalizmi shqiptar në Perandorinë Osmane*, Tiranë: Dituria, 2002, f. 25.

⁵⁰ H. Feraj, *Aspekte të mendimit politik ...*, f. 33.

⁵¹ *Po aty*, f. 33-34.

⁵² *Po aty*, f. 34.

⁵³ *Po aty*.

kundër autoritetit qendror bizantin⁵⁴. Kjo të jep përshtypjen, sikur ai po bën shaka me këtë ndarje dhe nuk e ka me të vërtetë. Ne jemi të detyruar të tregojmë të vërtetën, duke ndjekur evoluimin e orientimit politik të disa prej familjeve më të mëdha shqiptare.

Po e nisim me Principatën e Arbrit e drejtuar nga familja e Skurajve, e cila qysh në shek. XII-XIII është një nga lulet e bujarisë shqiptare, nga gjiri i së cilës dolën gjeneralë e strategë dhe i shërbyen në fillim Bizantit dhe më vonë Turqisë⁵⁵. Kjo familje kishte lidhje me kurorën bizantine. Dhimitri u martua me Komnenën, vajzën e Stefan Nemanjës dhe bijës së preferuar të perandorit bizantin Aleksi III Engjëlli, Evdhoksisë. Pas ndarjes nga Stefan Nemanja perandori ia dha strategut të fuqishëm Leon Skura⁵⁶. Kuptohet se martesë ishte një mjet politik për të siguruar kufijtë e veriut nga Stefan Nemanja. Një Progon Skura në vitin 1295 del në kishën e Shën-Klementit në Ohër së bashku me të shoqen, që mbante një titull të lartë bizantin (heteriark i madh)⁵⁷. Qysh nga mesi i shek. XIII pinjollë të kësaj familjeje bëjnë pjesë në përfaqësuesit e zgjedhur për të biseduar me Karl Anzhunë, dhe pak më vonë sipas venedikasve, kjo familje luajti një rol vendimtar në kalimin e Durrësit në duart e Venedikut⁵⁸. Pra u nis bizantinofilia dhe përfundoi filovenedikase.

Pa perënduar mirë ylli i Skurajve kishin dalë Topiajt. Konti Tanush Topia quhej “zot i viseve midis Matit dhe Shkumbinit, ndërsa pas tij princ Karl Topia, u bë “zot i gjithë viseve të Arbrit”⁵⁹. Në vitet ’70 të shek. XIII një pinjoll i asaj familjeje kishte titullin “miles”. Në atë kohë u shkëputën nga Bizanti, duke vendosur lidhje të ngushta me Papatin e Romës dhe duke i premtuar kalimin nga riti ortodoks në atë katolik. Kjo e fundit e njohu zotëruese në tokat midis lumenjve Mat dhe Shkumbin. Ata pranuan vasalitetin ndaj anzhuinëve (1272-1338). Varësia mbeti formale sepse anzhuinët ankoreshin për “rebelimet dhe mosbindjen e Topiajve”. Megjithatë kishin interes ta mbanin të lidhur pas, prandaj ua falnin shpesh fajet e bëra, madje duke u dhënë dhe të holla. I vëllai i Tanushit ishte kapelan e këshilltar në oborrin e Napolit.

⁵⁴ *Po aty*.

⁵⁵ P. Xhufi, *Dilemat e Arbërit ...*, f. 79-80.

⁵⁶ *Po aty*, f. 82.

⁵⁷ *Po aty*, f. 83.

⁵⁸ *Po aty*, f. 86.

⁵⁹ *Po aty*.

Marrëdhëniet e Topiajve me anzhuinët mbetën të ngrira gjatë periudhës së Andreas, të birit të Tanushit, i cili kishte “rrëmbyer” vajzën e mbretit Robert që ishte nisur të martohej në Konstandinopol ndërsa mbreti i thirri, gjoja për t’u pajtuar, dhe i vrau të dy⁶⁰.

Karl Topia, djali i madh i Andreas, shfrytëzoi lidhjet e hershme me anzhuinët, duke vënë në dukje “lidhjet e gjakut” nga nëna. Sulmi mbi Durrësin (1362) bëri që të acarohen marrëdhëniet me anzhuinët dhe me Venedikun. Kjo e fundit nuk i prishi marrëdhëniet, por këshilloi që të vëzhgohej dhe të mos lejohej të ndërtonte as flotë, as një kështjellë. Madje Venediku e shpalli qytetar nderi Karl Topinë (1366). Anzhuinët nuk mund t’ia falnin “vasalit Karl Topia” marrjen e Durrësit (1368). Marrëdhëniet ishin ftohur edhe me Papatin, i cili kishte mbetur i pakënaqur nga “prirjet heretike të Karl Topisë dhe i akuzuar për ithtar i patartinëve⁶¹.

Karl Topia u lidh me Raguzën dhe me Mbretërinë e Hungarisë, por ishin lidhje koniunkturale pa ndonjë interes, vetëm, si armiq të Venedikut. Me marrjen e Durrësit, anzhuinët donin të kapnin si Karl Topinë dhe Gjergj Balshën, duke vënë një çmim prej 1 000 dukatë ari, por pa rezultat. Nga viti 1383 Karl Topia e bleu marrjen e Durrësit me një shumë të madhe. Atë nuk e mbajti shumë se ia rrëmbyen Balshajt (1384). Me ndihmën e osmanëve, pas betejës së Savrës (1385), Karl Topia hyri në Durrës, por si vasal i osmanëve. Për t’i shpëtuar vasalitetit, Karl Topia u hodh tek Venediku, duke i ofruar dhe protektoratin e Durrësit, apo duke ua shitur, por pa rezultat. Pasardhësi i tij, Gjergj Topia me një marrëveshje (1392) “de jure” njohu sundimin venedikas pas vdekjes së tij, e cila ishte planifikuar qysh më parë⁶².

Në vitin 1403 kont Niketë Topia mori kështjellën e Krujës nga duart e kushërirës, Helena, duke bashkuar rreth tij tokat rreth e rrotull Durrësit. Venediku i njohu zotërimet e tij si pengesë kundër osmanëve. Më 1412 Niketa u ndesh me Muzakajt dhe ra rob i tyre, por u lirua nga burgu me ndërmjetësinë e Raguzës. Por ai duhej të matej me osmanët, të cilët i intensifikuan sulmet dhe pas vdekjes së tij, Kruja ra në duart e osmanëve (1415)⁶³. Në vitin 1448 një komandant i Skënderbeut, Topia u kërkoi

⁶⁰ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll.I, f. 287.

⁶¹ *Po aty*, f. 287-288.

⁶² *Po aty*, f. 289-291; P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar (395-1831)*, Tiranë: SHBLU, 2009, f.101-103.

⁶³ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 291-292.

venedikasve strehim në Durrës, kurse Sinjoria urdhëroi të bënin çmos për të shkukur nga rrënjët shtetin e Skënderbeut dhe Dukagjinët, prandaj ata të mos strehoheshin në Durrës⁶⁴.

Siç u pa kjo familje ndërroi disa herë orientimin politik, nga ai bizantin në atë katolik (anzhuin apo venecian), më pas në atë osman dhe më vonë katolik.

Rrethanat politike bënë shpesh që familjet fisnike, si Matrënga, Muzaka, Zenebishi, Spata, Losha, kishin marrëdhënie me fuqitë katolike, si anzhuinët e Napolit ose Venedikun, madje edhe me vetë Papatin. Për rrjedhojë ndonjë pinjoll i tyre mund të jetë kthyer në katolik, ndonëse në përgjithësi mbetën ortodoksë⁶⁵.

Arianitët e nisnin aktivitetin politik me Davidin, patric dhe strateg bizantin të Selanikut qysh më 1001. Më 1274 sebast Aleks Arianiti del si një nga fisnikët shqiptarë që lidhi marrëveshje me Karlin I Anzhu, më 1304, ku u njihen privilegjet e mëparshme, kurse më 1319 papa Johani XXII u drejtohet fisnikëve shqiptarë, midis të cilëve ishte protolegatori Guljelm Arianit⁶⁶. Me fjalë të tjera, ishte kthyer nga orientim bizantin në katolik. Nga titujt e trashëguar del se kjo familje kishte lidhje me familjen perandorake (Komneni)⁶⁷. Komnen Arianit, i biri Gjergj Arianitit ishte martuar me vajzën e Nikollë Zaharisë, zot i qytetit të Buduas. Ai kishte tre djem: Gjergjin, Muzakën dhe Vladanin dhe një vajzë, që e kish martuar me Pal Dukagjinin. Muzaka kishte vetëm një djalë Moisiun me mbiemrin Golemi, bashkëluftëtar i Skënderbeut. Ai u martua me Zafinë Muzakën, ish gruan e Muzakë Topisë, i cili u rimartua me Mamicën, motrën e Skënderbeut. Vëllai i vogël i Gjergjit u martua me vajzën e Gjon Kastriotit, Angjelinën. Djali i tyre Muzaka i Angjelinës mori pjesë në Kuvendin e Lezhës më 1444⁶⁸.

Gjergj Arianiti u martua me Marie Muzakën me të cilën pati tetë vajza. Pas vdekjes së saj, ai u martua me një italiane Despina ose Petrina, vajza e guvernatorit të Leçes. Gjergji kishte tre djem: Thomain,

⁶⁴ L. Malltezi, "Dukagjinët dhe Skënderbeu ...", f. 91.

⁶⁵ *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. I, f. 251.

⁶⁶ Kristo Frashëri, *Gjergj Kastrioti Skënderbeu, jeta dhe vepra*, Tiranë: Toena, 2002, f. 31; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll. I, f. 297; Kasem Biçoku, "Shteti i Arianitëve" në *Për Skënderbeun*, Tiranë: 2005, f. 383.

⁶⁷ *Historia e popullit shqiptar*, vep.cit, f. 298; K. Biçoku, "Shteti i arianitëve ...", f. 384.

⁶⁸ K. Biçoku, "Shteti i arianitëve ...", f. 384-385.

Konstandinin, Arianitin dhe një vajzë⁶⁹. Arianitët kishin lidhje të shumta martesore me Muzakajt e Kastriotët, me Dukagjinët deri me despotin serb Stefan Brankoviçin, i cili pas pushtimit të Rashës prej osmanëve, u vendos pranë Skënderbeut (1459) në Krujë dhe u martua me një vajzë të Gjergj Arianitit. Si përfundim kjo familje kishte lidhje me Mbretërinë e Napolit, u kthye me bizantinët dhe së fundi u nda në dy drejtime: pro e kundërosmane.

Balshajt dalin si familje ortodokse pas mesit të shek. XIV. Gjatë pushtimit serb duhet të jenë një nga familjet e shpronësuar. Me shthurjen e Mbretërisë Serbe, tre vëllezërit Balsha iu vunë punës për të siguruar pavarësinë. Mbreti serb, Stefan Uroshi i konsideronte Balshajt “rebelë” dhe nxiste Venedikun dhe sundimtarët sllavë kundër tyre. Republika raguzane u dha tre vëllezërve qytetarinë raguzane (1361). Venediku përpiquej të krijonte një bllok antibalshaj me krerët shqiptarë nga familjet: Gjurashi (Cernojeviçi), Dukagjini, Zaharia, Dushmani, Shestani etj. Venediku nxiti dhe mbështeti edhe sundimtarë serbë si Stefan Uroshin dhe Vojsav Vojnovin kundër Balshajve.

Përpjekjet për t’u shtrirë drejt jugut i çuan Balshajt në përplasje me fisnikë të tjerë shqiptarë: Dukagjinët, Zahariajt e sidomos Topiajt. Më 1364 u ndeshën me Topiajt, por pësuan disfatë dhe vetë Gjergj I Balsha ra rob, por me ndërhyrjen e Raguzës, mike e dy shtëpive shqiptare, armiqësisë iu dha fund me një lidhje martesore të K.Topisë me motrën e Balshajve. Në përpjekjet për t’u shtrirë drejt veriperëndimit ndeshën në qëndresën e Venedikut, Mbretërisë së Hungarisë, Papatit, sundimtarëve sllavë të Bosnjës të cilët i detyruan që të hiqnin dorë nga një ndërmarrje të tillë⁷⁰.

Në vitin 1369 Balshajt shpallën kalimin në ritin katolik për forcimin e lidhjeve me fuqitë katolike të Perëndimit. Kjo u bë edhe për dy arsye të tjera: E para, të bëhej përputhja fetare me popullsinë e zonës, e cila ishte në shumicën e saj katolike dhe e dyta, Balshajt donin t’i ndërprisnin përfundimisht lidhjet me serbët dhe ortodoksizmin. Gjergji II Balsha mori pjesë në Betejën e Fushë-Kosovës (1389)⁷¹. Më vonë përballë osmanëve Gjergji II Balsha filloi të afrohej me Venedikun, pa ndërprerë

⁶⁹ Po aty, f. 385.

⁷⁰ K. Bozhori-F. Liço, *Burime tregimtare bizantine për Historinë e Shqipërisë, shek. X-XV*, f. 270, 277; *Historia e popullit shqiptar*, vëll. I, Tiranë, 2002, f. 301.

⁷¹ P. Thëngjilli, “Vlera e burimeve osmane për betejën e Fushë-Kosovës”, në *Studime historike*, Tiranë: 1989, nr. 4, f.155-161.

lidhjet tradicionale me kundërshtarët e saj, Raguzën dhe Hungarinë. Gjergji II u mundua të ruante deri në fund një farë distance nga osmanët, ndonëse ishte vasal i tyre. Ndryshe nga të tjerët, ai nuk shkoi të marrë pjesë në Betejën e Ankarasë (1402)⁷². Pas vdekjes së Skënderbeut, Balshajt morën trashëgiminë e Kastriotëve në Shqipërinë e Mesme, e cila zyrtarisht u njoh prej Venedikut⁷³.

Nga kjo paraqitje telegrafike e ngjarjeve nuk mund të përcaktosh se familja e Balshajve nuk ishte me qëndrim ortodokso-bizantin, por as serbofil, as katolik dhe as osman. *Ajo ishte një familje shqiptare që shikonte interesat e saj dhe shfrytëzonte të gjitha rrethanat e brendshme dhe të jashtme, duke bashkëpunuar edhe me ata që deri dje ishin kundërshtarë të tyre. Orientimin ajo e kishte në funksion të ekzistencës dhe të realizimit të qëllimeve të saj.*

Qysh në vitin 1090 nga familja Muzaka ishte një nga komandantët më të shquar të Aleks Komnenit, gjatë luftërave me anzhuinët e Napolit, pra ishte me orientim bizantin. Gjon Muzaka I ishte një nga krerët e qëndresës kundërbizantine. Andrea Muzaka II (1335-1372) lidhi një aleancë me anzhuinët e Napolit, duke lënë si peng në Durrës një nga djemtë e tij. Pas shtypjes së kryengritjes së vitit 1336 kjo familje u shpronësua dhe u strehua në Greqi (Peloponez). Gjatë sundimit serb kjo familje ishte frymëzuesja e qëndresës në zonën e Beratit dhe të Vlorës, pra ishte antiserbe. Aty nga viti 1350 Andrea II Muzaka mori Beratin dhe prej andej u shtri në krejt Myzeqenë. Pas vdekjes së Stefan Dushanit, Andrea II Muzaka doli deri në kufij me zotërimet e Topiajve. Me ndihmën e Balshajve, Andrea II Muzaka theu forcat e sundimit serb Vukashin (1370), kurse perandori bizantin i dha titullin despot së bashku me shqiponjën me dy krerë me yll në mes. Me fjalë të tjera u bë me orientim probizantin. Pas vdekjes së tij zotërimet e principatës u ndanë midis bijve të tij⁷⁴. Nga gjiri i kësaj familjeje do të kemi dy degëzime njëra kundërosmane dhe tjetra pranoi fenë islame dhe vasalitetin dhe iu ngjiti shkallëve të hierarkisë shtetërore. Teodor Muzaka, si kundërosman, mori pjesë në Betejën e Fushë-Kosovës, ku dha jetën⁷⁵.

⁷² *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f.306.

⁷³ Oliver Jens Schmitt, *Vitet e fundit ...*, f. 60.

⁷⁴ *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 292- 295.

⁷⁵ Rreth këtyre dy degëzimeve shih S. Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare (shek. XV-XVI)*, Tiranë, 1988, f. 36; F. Duka, "Fisnikëria shqiptare dhe qëndresa e

Deri këtu nuk mund të përcaktosh se kjo familje ishte me qëndrim ortodokso-bizantin, por as katolik, as osman. *Ajo ishte një familje shqiptare që shikonte interesat e saj dhe shfrytëzonte të gjitha rrethanat e brendshme dhe të jashtme, si motrat e saj.*

Nga sa pamë deri këtu del se familjet e mëdha shqiptare janë produkt i kushteve në të cilat lindën dhe u zhvilluan ato, që lidhen kryesisht me periudhën dhe sundimet e huaja: bizantin, bullgar, serb, anzhuin dhe norman, prandaj mbajnë vulën e asaj kohe. Zhvillimi i ngjarjeve i detyroi ato t'u përshtateshin kushteve të reja. Ato ishin midis disa zjarreve nga lindja, nga veriu dhe nga perëndimi. Vetë ekzistenca i detyronte ato të ndërroinin shpesh herë orientimin politik dhe fetar. Madje brenda një familjeje kemi disa orientime politike. Kjo duket nga titujt që mbanin pinjollët e një familjeje. Disa mbanin tituj bizantinë, disa të tjerë sllavë dhe të fundit katolikë. Jo rrallë i njëjti person mbante të gjithë titujt. Por asnjëherë nuk kemi ndarje me thikë të orientimeve politike dhe fetare. Me fjalë të tjera pretendimi i H.Ferajt nuk gjen asnjë mbështetje dokumentare.

Teza tjetër e H. Ferajt është se ngjitja e shkallëve të hierarkisë shtetërore osmane u bë për arsye etnike dhe si një sistem më i lehtë. Madje pretendohet se familja e Zenebishëve e ndërroi fenë shumë kohë para se të vinin osmanët në kontakt me shqiptarët para rrezikut sllav dhe për më tepër komandanti i parë, që hyri në Konstandinopojë ishte shqiptar⁷⁶.

Dihet nga të gjithë se pushtimi osman i tokave shqiptare ndoqi dy faza: atë të vasalitetit dhe atë të pushtimit të plotë, ashtu si në krejt Ballkanin. Sigurisht dy fazat patën veçoritë që e bëjnë atë të dallohet nga vendet e tjera. Periudha e vasalitetit nuk nisi dhe mbaroi në të njëjtën kohë për të gjitha tokat shqiptare. Ajo filloi qysh në vitin 1382 me zonat juglindore (Korçë, Përmet e Konicë) dhe zgjati vetëm 10 vjet (1382-1392); për krahinat e Shqipërisë Jugore e Qendrore vazhdoi deri në vitet '20 të shek. XV, për viset e Shqipërisë së Mesme e Veriore shkoi deri në vitin 1443, kurse për viset e Rrafshit të Dukagjinit e të Fushë-Kosovës deri në vitin 1455, kur ato njohën pushtimin osman⁷⁷.

Skënderbeut: rasti i Muzakajve", në *Gjergj Kastriot-Skënderbeu në historinë e shqiptarëve*, Tiranë: 2005, f.23-36.

⁷⁶ H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar ...*, f. 34-35.

⁷⁷ S. Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare ...*, f.29-30.

Një veçori tjetër kishte të bënte me detyrimet e fisnikëve shqiptarë. Princat shqiptarë, duke njohur sulltanin si kryezot, ishin të detyruar ta ndihmonin me ushtri në rast se sulltani u bënte thirrje, të jepnin një tribut të përvitshëm (haraç) dhe të jepnin fëmijët e tyre si pengje pranë oborrit të sulltanit (içogllan) ose pranë dinjitarëve të zonave kufitare (gulam), si garanci për vasalitetin. Në pozita të tilla ranë familjet më të njohura si: Balshajt, Topiajt, Dukagjinët, Zahariajt, Muzakajt, Zenebishët, Aranitët dhe Kastriotët⁷⁸.

Gjatë vasalitetit nëpërmjet sistemit të içogllanëve dhe të gulamëve u integruan në klasën osmane pinjollë të këtyre familjeve të mëdha shqiptare. Tipike janë familjet e Muzakajve, e Zenebishëve, të Ashtinëve, Dukagjinave, Kastriotëve, etj. Ngjitja e shkallëve u bë për arsye ekonomike dhe politike, për të ruajtur zotërimet e mëparshme, ose për t'i zmadhuar ato⁷⁹. Si rezultat i këtyre masave, klasa feudale shqiptare u nda në tri grupe kryesore: grupin e parë e përbënin feudalët e integruar në klasën osmane nëpërmjet dy sistemeve; grupin e dytë e përbënin ato familje që mundën të ruanin diçka si spahinj të krishterë dhe të tretin e përbënin feudalët e mëdhenj shqiptarë, të shpronësuar krejtësisht nga zotërimet e tyre⁸⁰.

Periodha e dytë, ajo e pushtimit nis me fundin e shek. XIV dhe vazhdoi gjysmën e dytë të shek.XV. Në zonat e pushtuara u vendosën garnizone ushtarake dhe administrata tjetër osmane, ku u zbatua sistemi feudal- ushtarak⁸¹. Vetë autori e pranon se motivet nacionale nuk mund t'i gjesh në burimet e shkruara⁸². Kjo do të thotë që t'i presësh rrugën atij që mendon ndryshe dhe të zbukurosh realitetin historik.

Në lidhje me pretendimet se Zenebishët u islamizuan para se shqiptarët do të binin në kontakt me osmanët, kemi konstatuar se burimet e shkruara, kryesisht ato bizantine, dëshmojnë se Zenebishët dalin qysh në vitin 1304, por shkëlqimin më të madh e arritën në gjysmën e dytë të

⁷⁸ *Po aty*, f. 31; K. Frashëri, *Skënderbeu, jeta dhe vepra*, Tiranë: Toena, 2002, f.94; P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.131-132; Më hollësisht shih kumtesën e F. Duka, e përfshirë në këtë vëllim.

⁷⁹ S. Pulaha, "Mbi gjendjen në vitet 20-30 të shek. XV në tokat shqiptare dhe mbi qëndrimin e klasës feudale kundrejt pushtimit osman", në *Studime historike*, nr. 4, f. Tiranë: 1970, f. 111-157.

⁸⁰ S. S. Pulaha, *Pronësia feudale në tokat shqiptare ...*, f.61-63.

⁸¹ *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 374-378.

⁸² H. Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar ...*, f. 34.

shek. XIV, gjatë periudhës së Gjon Zenebishit (1418). Me zgjerimin e territoreve në fushën e Vajonetisë (Vagenetisë) zotërimet e saj dolën në kufij me zotërimet e Gjin Bua Spatës. Të dy së bashku sulmuan despotin serb Thoma Preljuboviçi, mbeturina e fundit serbe në Shqipërinë e Jugut, por atë e shpëtuan forcat osmane. Pas vdekjes së tij, despoti i ri i Janinës, Ezau Buondelmonti Ajaçuoli (1386-1411) me ndihmën e osmanëve i mori mjaft zotërimet Gjon Zenebishit, si tregjet e Sajadhës⁸³. Me fjalë të tjera, armiqtë kryesorë ishin osmanët dhe serbët. Pas Ajaçulit doli një armik tjetër, Venediku. Pas luftimeve të ashpra Gjoni hoqi dorë nga Sajadha⁸⁴. Pas vdekjes së Ezaut (1411), Evdoksia Balsha, vajza e Gjergjit I Balsha iu kundërvu parisë së Janinës për t'ia dorëzuar atë nipit të despotit kontit të Qefalonisë, Karl Tokos, por Dhespina arbëreshe me një komplot u dëbua nga Janina⁸⁵.

Zenebishët jo vetëm që i bënë ballë, por korrën fitore të bujshme sa Karl Toko u detyrua të kërkojë ndihmën e osmanëve, lidhi aleancë me ta, duke e vulosur me martesën e bijës së tij me Musa Beun, pretendentin e fronit. Në vitin 1418 ushtria osmane përshkoi territoret e kësaj principate. Trashëgimtarët e principatës u strehuan në Korfuz, prej nga vazhduan luftën. Kryengritjet e herëpashershme, ftesat dhe ardhja e pinjojeve të kësaj familje dëshmojnë se deri tani kjo familje nuk u bë mike e osmanëve⁸⁶. Siç rezultojnë kjo familje armikun kryesor kishte osmanët prandaj pretendimi i autorit bie në kundërshtim me burimet e shumta bizantine.

Pjesëmarrja e një shqiptari në pushtimin e Konstandinopojës nuk jep asgjë në favor të kësaj pikëpamjeje, mbasi shqiptarët kanë marrë pjesë si aleatë të osmanëve rreth 50 vjet më parë, si në Betejën e Ankarasë, etj. Për këtë figurë do të flasim më poshtë.

Ngjitja e shkallëve të administratës osmane për arsye etnike nuk mund të vërtetohet. Ne jemi me mendimin se përqaftimi i fesë islame kryesisht në Kosovë, dhe në krahinat periferike të tokave shqiptare ka luajtur një rol në ruajtjen e shqiptarëve, por kjo ka ndodhur shumë vonë, vetëm që nga gjysma e dytë e shek. XVI, kurse për krahinat e tjera, as që

⁸³ K.Bozhori-F.Liço, *Burime tregimtare bizantine ...*, f. 246, 240-250, 277-278, 281-288, 299, 309-314, 327-329.

⁸⁴ *Po aty*, f. 276; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 284-286.

⁸⁵ K.Bozhori-F.Liço, *Burime tregimtare bizantine ...*, f.277-278.

⁸⁶ *Po aty*, f. 281, 282, 284, 287, 311-313, 314, 327-329; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll. I, f. 287.

bëhej fjalë për rrezikun grek dhe atë sllav, i cili filloi të marrë trajtë dhe të nxjerrë dhëmbët që nga vitet '30 të shek. XIX. Të pretendosh se në shek. XV rreziku kryesor ishte ai fqinj do të thotë të dhunosh realitetin historik.

Përsa i përket çështjes në se ishte sistemi osman më i lehtë nga ai bizantin, nuk mund të përgjigjesh mbasi për periudhën bizantine nuk ka studime rreth detyrimeve, ashtu siç ka për periudhën osmane, prandaj nuk mund të shpreh mendimin pro apo kundër kësaj teze.

Gjatë periudhës bizantine ka pasur disa rreziqe: ballkanas apo fqinj dhe ai jashtë Ballkanit. Secili ka vendin e vet. H.Feraj pretendon se më të këqij ishin rreziqet fqinjë: ai serb dhe ai grek në shek. XIV-XV. Unë mendoj se tokat shqiptare kanë qenë para rreziqeve të mëdha, para udhëkryqeve, por ato nuk kanë qenë të njëjta dhe me të njëjtin intensitet, prandaj është e vështirë të shtrish efektin e një rreziku gjatë gjithë historisë së popullit shqiptar. Kështu, me ndarjen e Perandorisë Romake (395), tokat iliro-arbërore ishin nën Bizantin, prandaj rreziku ishte ai bizantin dhe jogrek. E theksojmë “jogrek” sepse mjaft autorë venë shenjën e barazimit midis Bizantit dhe rrezikut grek, mbasi shteti bizantin vijoi si një vazhdim i jetës romake, duke ruajtur për disa shekuj elementët latinë si titujt, gjuhën zyrtare, organizimin shtetëror deri në dinastinë Heraklite (610-711)⁸⁷.

Me reformat e Heraklit mbyllet periudha romake dhe nisi ajo bizantine në kuptimin e vërtetë të fjalës. Brenda këtij rreziku kalojnë disa rreziqe të tëra, ndofta më të mëdha se ai bizantin. E fillojmë me dyndjen barbare ose me dyndjen e madhe të popujve (shek. IV-VII), e përbërë nga fise gjermanike, hunët, turanikët, avarët, sllavët dhe protobullgarët. Sulmet e para deri tek sllavët patën karakter plaçkitës dhe shkatërrues, por ishin të përkohshme dhe kalimtare. Me sllavët ndryshonte puna mbasi ata u ulën këmbëkryq në një pjesë të mirë të Gadishullit Ballkanik, si në krahinat e Bullgarisë së sotme dhe në Ilirinë e Veriut, nga ku dëbuan ose asimiluan elementin vendas. Kjo solli ndryshimin etnik të popullsisë, kurse në rajonet ku u vendosën me pakicë, si në Dardani, në Prevalitani, Epirin e Vjetër dhe të Ri, u asimiluan nga popullsia vendase dhe rreziku ishte më i vogël⁸⁸.

⁸⁷ P.Thëngjilli- S.Daci, *Historia e Perandorisë Bizantine (395-1453)*, Tiranë: 1997, f. 91-92.

⁸⁸ P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f. 33-34; P.Thëngjilli- S.Daci, *Historia e Perandorisë Bizantine ...*, f. 75-79.

Në shek. IX-X del në plan të parë rreziku bullgar. Midis viteve 837-847, bullgarët u shtrinë në tokat e Maqedonisë e të Fushë-Kosovës dhe filluan të përparojnë drejt viseve lindore shqiptare dhe në vitet '50 ata morën Ohrin, Devollin e Beratin deri në Detin Adriatik. Tokat e pushtuara formuan një krahinë administrative më vete me emrin "Toka të sapopushtuara"^{*}. Pushtimi bullgar zgjati për disa krahina 150 vjet. Ky sundim ishte më i lehtë se ai bizantin. Mbas shembjes së shtetit bullgar, mbi tokat shqiptare u rivendos sundimi bizantin⁸⁹.

Nga fundi i shek. X në viset e Malit të Zi të sotëm u formua shteti i Dioklesë nën drejtimin e Gjon Vladimirit. Pas rënies së shtetit bullgar doli një rrezik tjetër, me pushtimin prej tyre të krahinës së Kosovës dhe të tokave shqiptare deri në lumin Vjosë. Ky ekspansion serb u shoqërua me dukuri të karakterit politik, kishtar dhe etnik, por nuk solli ndryshime thelbësore në gjirin e popullit shqiptar⁹⁰.

Në fillim të viteve '80 të shek. XI doli rreziku norman. Disa territore të Shqipërisë jugperëndimore kaluan nën sundimin norman. Luftrat normano-bizantine u kushtuan shumë shqiptarëve. Vendi pësoi dëme të mëdha njerëzore e materiale⁹¹. Në vitin 1261 trevat shqiptare ndodheshin nën sundimin e disa shteteve njëkohësisht: ato të veriut nën Mbretërinë e Serbisë, ato të Jugut nën despotatin e Epirit, në perëndim nën Mbretërinë e Sicilisë, kurse krahinat e brendshme nën Perandorinë Bizantine. Me marrëveshje dhe me përpjekje për 15 vjet anzhuinët morën nën zotërim ultësirën bregdetare midis Durrësit deri në Himarë e Butrint, por u larguan nga tokat shqiptare⁹².

Në vitet '30 të shek XIV doli rreziku serb. Në verën e vitit 1336 Stefan Dushani pushtoi rajonet midis Matit dhe Shkumbinit, në vitin 1343 nënshtroi tokat e Arbërisë, tre vjet më vonë mori Kosturin, Beratin e Kaninën dhe brenda 2-3 vjetëve, ai e shtriu sundimin në krejt Epirin dhe Thesalinë deri në Egje. Kudo u vendos një administratë e përbërë nga

* Kutmiçevica.

⁸⁹ P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.77-79; *Historia e popullit shqiptar*, vëll.I, f. 218-220.

⁹⁰ P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.81-83; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 222-223.

⁹¹ P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.83-85; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 224-227.

⁹² P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.88-91; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 239-244.

serbë dhe vegla të tyre. Shqiptarët u shtypën keq nën zgjedhën e “rëndë e të urreyer sllave”. Gjatë pushtimit serb u intensifikua shfrytëzimi feudal. Shumë toka të bashkësive iu dhanë manastireve dhe feudalëve serbë. Në fushën politike pushtimi serb nuk lejoi zhvillimin normal të afirmimit të formacioneve feudale shqiptare të pavarura. Pasojat negative u ndien më shumë në Kosovë, e cila kishte qenë e pushtuar nga serbët qysh më parë dhe nga shek.XIII kishte shërbyer si seli e kryeqyteteve serbe. Aty u zëvendësua klasa shqiptare me aristokracinë serbe; u themeluan një numër i madh manastiresh me prona të mëdha tokësore; u vendosën mjaft kolonë serbë të sjellë nga territoret serbe të Rashës. Në fushën fetare popullsia që nuk pranonte të kthehej në fenë ortodokse, pësonte dënime të rënda, si: sekuestrim pasurie, damkosje, dëbim deri në dënim me vdekje. Proceset e sllavizimit të shqiptarëve në Kosovë nuk arritën në asimilimin etno-kulturor. Elementi serb mbeti në minorancë. Shqiptarët i bënë një qëndresë, duke filluar nga format e ulëta deri në kryengritjet e armatosura⁹³.

Kur disa rreziqe vepronin në të njëjtën kohë, padyshim se rreziku serb ishte më i madhi, kurse rreziku grek ishte më i vogli, para vdekjes së Stefan Dushanit (1355). Pas tij, filloi të bjerë rreziku serb. Qeveritarë serbë ishin në Epir, në despotatin e Janinës, por pa një kërcënim serioz⁹⁴. Pas rrezikut serb shfaqet rreziku osman⁹⁵.

Teza tjetër është ndarja e shoqërisë në “Skënderbegas” dhe “vasalistë”. H. Feraj mendon se rryma e qëndresës me armë kundër osmanëve në bashkëpunim me fqinjët sllavo-ortodoksë, të udhëhequr prej Skënderbeut përbën “Skënderbegasit”, kurse ata që bashkëpunuan me osmanët, si armiku më pak i rrezikshëm se armiku ballkanik, i quan “vasalistë”⁹⁶. Në rrymën e vasalistëve ai përfshin M.Golemin, Hamza Kastriotin, Familjen Dukagjinase dhe Ballaban Pashën e ndonjë tjetër.

Që të përfaqësosh një rrymë duhet të kesh të qartë idetë politike dhe të luftosh për t’i materializuar ato, kurse tek këta persona nuk ndodhi një gjë e tillë.

⁹³ P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.92-94; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 275-279.

⁹⁴ *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 279-281.

⁹⁵ Mbi rrezikun osman dhe përhapjen e shpejtë në Ballkan shih. P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, nr. 1, f.471-487.

⁹⁶ Feraj, *Skicë e mendimit politik shqiptar ...*, f. 35-36.

Moisi Golemi deri para Betejës së Beratit (1455), del si një nga njerëzit më besnikë dhe të përkëdhelur të Skënderbeut, me zotërime, me tituj dhe me pasuri të konsiderueshme. *Tradhtia e M.Golemit ishte një lajthitje e rastit dhe aspak e menduar, gjë që i kushtoi kokën e vet.*

E njëjta gjë mund të thuhet edhe për tradhtinë e Hamzait. Ajo i ngjan as më shumë dhe as më pak, asaj të Moisi Golemit.

Sipas autorit të pikëpamjes vasaliste arsytet e armiqësisë së Dukagjinasve me Skënderbeun duhen kërkuar në qëndrimin miqësor të Skënderbeut ndaj Brakonviçit, armikut më të madh të shqiptarëve të Kosovës⁹⁷.

Unë mbështes pikëpamjen se shkaqet ishin ato ekonomike dhe politike dhe aspak etnike. Në rast se Lekë Dukagjini do të ishte më të vërtetë “vasalist”, ai pas vdekjes së Skënderbeut do të ishte kthyer me osmanët, por ai bëri të kundërtën. Më 1501 një pasardhës i vëllezërve Dukagjini që jetonte në Itali u kthye për të udhëhequr kryengritjen në Shqipërinë e Mesme, por më pas, bëri një marrëveshje me osmanët dhe mori titullin e pashës dhe qeverisi një pjesë të zotërimeve të Dukagjinëve⁹⁸. Nga kjo familje kemi dy degëzime: I pari ruajti karakterin e mëparshëm antiosman⁹⁹, kurse i dyti, ai mysliman, arriti në majat më të larta të administratës osmane¹⁰⁰, si vezirë të mëdhenj¹⁰¹. Figura të tjera u dalluan në fushat e letërsisë dhe të artit¹⁰².

Ballabani ndryshon nga “vasalistët” e tjerë. Ai ishte marrë peng, ishte bërë jeniçer, kishte fituar tituj dhe grada, zotërime dhe poste edhe në Shqipëri. Ai vetë kishte një zotërim të madh në krahinën e Tetovës. Po kështu fëmijët e tij kishin zotërime. Ai deri në fund i qëndroi besnik sulltanit, u soll si një komandant tipik osman dhe as që mendoi se ishte shqiptar; grabiti, dogji, vrau e preu, prandaj nuk mund të quhet vasalist. *Si përfundim mendojmë se nuk kemi asnjë rrymë vasaliste.*

⁹⁷ H. Feraj, “Mbi debatin për Skënderbeun ...”, në gazetën *Rimëkëmbja*, 1 shkurt 2000.

⁹⁸ I. Zamputi, *Dokumente kryesore për historinë e Shqipërisë*, nr.2; I Zamputi, *Përpyjekjet e shqiptarëve për liri gjatë dy shekujve të parë të sundimit otoman*, Tiranë: 1961; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 310.

⁹⁹ Më hollësisht shih P.Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, f.33.

¹⁰⁰ *Po aty*, f.108; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.I, f. 310.

¹⁰¹ P.Thëngjilli, “Shqiptarët gjatë luftës austro-osmane (1683-1699)”, në *Studime Albanologjike*, nr. 2, Tiranë: 1999, f. 108.

¹⁰² *Po aty*, f. 25-26-27.

Në qoftë se deri këtu tezat bien në kundërshtim me bazën burimore dhe si të tilla janë vetëm dëshira, që nuk mund të realizohen, tezat mbi figurën e Skënderbeut janë akoma më denigruese dhe hedhin baltë direkt mbi figurën e tij.

Po e nisim me orientimin fetar të familjes së Kastriotëve në përgjithësi dhe të Skënderbeut në veçanti, të lidhjeve të tij me krishterimin perëndimor dhe atë katolik. Ashtu si familjet e tjera shqiptare, edhe familja e Kastriotëve e ndërroi orientimin politik e fetar disa herë, madje më shumë se të tjerat. Gjon Kastrioti nga ortodoks u kthye në katolik, më vonë u bë mysliman dhe më në fund katolik. Të njëjtën rrugë bëri edhe i biri, Skënderbeu. Në këto rrethana familja dhe vetë Skënderbeu nuk mund të kishin bindje të thella fetare. Por atë H.Feraj e akuzon me prirje ortodokse-sllave, kur më tepër nëna e tij na qenka sllave, kur pjesa më e madhe e familjes së tij ishte nën ndikimin ortodoks të nënës, të vëllezërve dhe motrave, si Konstandini, Reposhi, Vllajka, Jella etj., deri tek varrimi i të vëllait të tij me nderim të madh në manastirin e shenjtë të Hilandarit në Greqi¹⁰³. Në të vërtetë nëna e Skënderbeut ishte një bujare me përkatësi etnike të pastër shqiptare. Në këto rrethana nuk mund të arrish në përfundimin e gabuar se prirjet politike të Skënderbeut konstatohen si prirje drejt krishterimit ortodoks lindor.

Dihet se miqësitë e vërteta midis popujve kanë rrënjë të thella dhe ato çelikusen gjatë historisë nëpërmjet marrjeve dhe dhënieve në të gjitha fushat e jetës, gjatë bashkëpunimit dhe ndihmës reciproke, por e vërteta është se marrëdhëniet nuk kanë shkuar në të njëjtën vijë. Krahas aspekteve të bashkëpunimit gjatë historisë shekullore ka pasur edhe përplasje, luftëra, vrasje, djegie, të cilat i largojnë popujt nga binarët e miqësisë. Po të bëjmë një krahasim midis aspekteve të bashkëpunimit dhe të ndeshjeve të shqiptarëve me fqinjët, del se më shumë janë këto të dytat. Banorët e rajoneve kufitare janë kacafytur edhe për gjëra të jetës së përditshme, si kullotje e rrëmbim bagëtish, grabitje shtëpish dhe mallrash të njëri-tjetrit dhe të tregtarëve.

Së dyti, duhet të dallojmë miqësinë midis popujve për të cilën folëm më lart nga marrëveshjet e udhëheqësve politikë përfshi edhe Skënderbeun. Ai ka pasur marrëdhënie me disa sundimtarë serbë, si me Gj. Brankoviçin e Serbisë dhe më vonë me Stefanin; me birin e Hercegut,

¹⁰³ H. Feraj, "Mbi debatin për Skënderbeun ...", në *Rimëkëmbja*, 1 shkurt 2000.

por asnjë herë me sundimtarë grekë. Marrëdhëniet midis tyre nuk i kalojnë kornizat politike dhe kanë uljet dhe ngritjet e tyre. Mjaft prej tyre mbetën në letër dhe kjo për shumë arsye. Çfarë miqësie mund të lidhte Skënderbeu me Gj. Brankoviçin, kur ai nuk i dha lehtë atij të bashkohej me Huniadin në Fushë-Kosovë. Vladislavi në vitin 1453 kishte relata të mira me Skënderbeun, por pas tre vjet u lidh me osmanët. Më 1457 mbreti boshnjak lidhi aleancë me Skënderbeun për luftë kundër osmanëve, por nuk ndërmoi asnjë veprim. Me rënien e plotë të shtetit serb (1459) despoti Stefan erdhi në Shqipëri, ku qëndroi për disa vjet pranë Skënderbeut. Në vitin 1463, kur ushtritë osmane filluan pushtimin e Bosnjës, Skënderbeu ishte gati të ndihmonte boshnjakët, por u pengua nga Venediku, mbasi vonoi lejen për kalimin e trupave shqiptare nëpër tokat venedikase derisa ushtritë osmane e pushtuan Bosnjën¹⁰⁴.

Nga sa pamë deri këtu përpjekjet e Skënderbeut kanë qenë më se korrekte ndaj aleatëve për një luftë të përbashkët dhe nuk i duhet dhënë atij roli i krijuesit të miqësisë me popujt e Ballkanit, kryesisht sllavë dhe grekë. Është e vërtetë se gjatë rrjedhës historike individit ka luajtur rol në forcimin ose tendosjen e marrëdhënieve midis shteteve fqinjë, por nuk duhet absolutizuar ky rol në krijimin e miqësive midis popujve. H. Feraj është i bindur se nga historianët zyrtarë të 50 viteve të fundit figura e Skënderbeut është përdorur ndër të tjera edhe për të treguar se ndërmjet shqiptarëve e serbëve ka pasur miqësi shekullore që është kalitur në fushën e luftërave të përbashkëta kundër të njëjtit armik etj, etj¹⁰⁵.

Kjo është e vërtetë kur politika kishte nevojë të tregonte se kjo miqësi kishte rrënjë të thella pavarësisht se ato nuk vazhduan gjatë. Kështu, gjatë viteve 1945-1948 propagandohej roli i E. Hoxhës në farkëtimin e miqësisë me popujt e Jugosllavisë, më vonë në farkëtimin e miqësisë shqiptaro-sovjetike dhe shqiptaro-kineze. Në ndonjë rast është shkuar edhe më larg, siç ishte rasti i miqësisë shqiptaro-turke, ku përsëri një rol parësor i jepej E. Hoxhës. Marrëdhëniet shqiptaro-turke janë shumë të vjetra dhe rrënjët duhen kërkuar në historinë e përbashkët, në marrjen e dhënien në të gjitha fushat e jetës, në integrimin e mjaft shqiptarëve myslimanë në shkallët e administratës shtetërore, në bashkëjetesën nën një çati etj.

¹⁰⁴ Më hollësisht shih P. P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f. 176.

¹⁰⁵ H. Feraj, "Debat mbi Skënderbeun ...", në gazetën *Rimëkëmbja*, 22 shkurt 2000.

Skënderbeu kuptoi mjaft mirë rrezikun më të madh atë osman, prandaj doli në krye të luftës. Bashkohem me ata që theksojnë se Skënderbeu për një çerek shekulli është mbrojtës i Europës në kuptimin ushtarak dhe në kuptimin e mbrojtjes së qytetërimit evropian, qytetërimit perëndimor përballë barbarisë lindore. Duke e mbrojtur Evropën nga pushtimi ushtarak osman, Skënderbeu ka mbrojtur qytetërimin perëndimor evropian. Nuk kishte rëndësi se nga do ta sulmonin osmanët Perëndimin, por ka rëndësi që të gjitha përprjekjet i bënë nga tokat shqiptare dhe shqiptarët vonuan për 25 vjet zbarkimin në Itali. Sa për rrugë të tjera, siç ishte Danubi nuk besoj se H. Feraj është më strateg se sulltanët dhe vezirët e mëdhenj të asaj kohe. Ata kishin përballë Hungarinë, e cila i rezistoi sulmeve osmane edhe shumë vjet pas rënies së kështjellës shqiptare, deri në vitet '40 të shek. XVI. Një pengesë tjetër ishte Austria e cila jo vetëm që nuk e la përparimin drejt Perëndimit, por theu osmanët më 1529¹⁰⁶.

Pyetjes së H.Ferajt pse Perandoria Osmane nuk e pushtoi Evropën pas vdekjes së Skënderbeut, kur nuk mbrohej prej tij, mund t'i përgjigjemi se sulltan Pushtuesi (Fatihu) vdiq, kurse pasardhësi i tij nuk kishte ato ambicie dhe nuk ishte i zoti t'i realizonte ato. Siç dihet nga të gjithë, shteti osman vazhdoi luftimet deri më 1606 me nënshkrimin e paqes në Sitvator, e cila sanksionoi dështimet e para në politikën e jashtme, si ajo e Astrahanit (1569), ajo e Lepantos (1571) me luftërat kundër Austrisë në vitet '90 të shek. XVI¹⁰⁷.

Në përgjigje të akuzës se Skënderbeu mund të interpretohet si udhëheqës shqiptar që përftoi fillimin e luftërave fetare ndërmjet shqiptarëve, i përgjigjemi se a mund të ishte Skënderbeu intolerant, kur vetë e ndërroi disa herë fenë. Është e vërtetë se ai mori epitete të ndryshme si "atlet i krishtit", kurse personalisht do të vihej në krye të një kryqëzate të organizuar nga Papa, por që nuk u realizua. Ai nuk mund të nisej nga motive fetare katolike në luftën kundër osmanëve, por u përpoq të mobilizojë gjithë faktorin ndërkombëtar në realizimin e qëllimeve, që i kishte vënë vetes.

Dihet se kur Skënderbeu mori nga Selia e Shenjtë dhe Papa Pali II të holla të pakta, ai deklaroi se nuk duhej të luftonte kundër turqve, por kundër kishës. Megjithatë, ai duke u rezistuar turqve për një çerek

¹⁰⁶ Më hollësisht shih. P. Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane ...*, f. 33-35.

¹⁰⁷ *Po aty*, f. 339-40.

shekulli, u bë mbrojtës i krishterimit perëndimor. S'ka rëndësi në se ky krishterim ishte papnor apo më i gjerë. Kjo nuk ia ul vlerat Skënderbeut. Shkuarja në ndihmë të Ferdinandit të Napolit nuk u bë nga motivi fetar, por nga ndjenja e detyrës ndaj traktatit të Gaetës.

I pasaktë është edhe mendimi i H.Ferajt se figura e Skënderbeut është trajtuar vetëm nga disa rilindas. Në bashkohemi me mendimin se nuk ka rilindas që të mos ketë shkruar për Skënderbeun. Autori S.Frashërin e përfshin në rrymën vasaliste, por realiteti historik është mjaft kokëfortë. Përveç sythit kushtuar Skënderbeut në fjalorin enciklopedik gjeografik, S.Frashëri vlerësimin lapidar për Skënderbeun e ka dhënë në veprën *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet*. Ai thekson ndihmesën e Skënderbeut në luftë dhe besnikërinë ndaj atdheut, aftësinë e tij për të bashkuar krerët shqiptarë, të cilët lidhën besë se do të vdisnin për shpëtimin e Atdheut, se për herë të parë Shqipëria u mbledh në një mbretëri me një mbret trim e të zotin si Skënderbeun, i cili e mbajti Shqipërinë të bashkuar dhe të pamposhtur për disa vjet, se sundimtarët e Evropës që nuk ishin trima si Skënderbeu, kishin shpresa tek ai, se vetëm në kohën e tij kombi shqiptar u mbledh në një qeveri të dliërë dhe iu dëgjua emri në tërë botën, me nder të madh, nga lufta kundër turqve. Samiu dëshironte të krijohej një shtet i lirë, si në kohën e Skënderbeut. Si shenjë vlerësimi ai propozonte që kryeqytetin e atij shteti ta quante Skënderbegas¹⁰⁸.

A ka vlerësim më të madh se kaq sa ta përjetësosh Skënderbeun me emrin e kryeqytetit të shtetit shqiptar të ardhshëm? S'ka përgjigje më të saktë ndaj pikëpamjes antiskënderbejane.

Kritika ndaj Skënderbeut që nuk pranoi pozitën e vasalitetit, i propozuar nga sulltani është pabaza. Në disa raste Skënderbeu nuk ka hezituar të zhvillojë bisedime me vetë shtetin osman dhe të përfundojë dy marrëveshje armëpushimi. Në vitin 1460 ai arriti marrëveshjen e armëpushimit trevjeçar për shkak se vendi kishte nevojë për pak qetësi pas luftërave dhe nga ana tjetër, donte të sigurote krahët gjatë ekspeditës në Itali. Osmanët nuk e respektuan marrëveshjen. Duke përfituar nga mungesa e tij, ata filluan provokimet dhe përgatitjet e forcave të shumta, sa e detyruan Skënderbeun të kthehej në Shqipëri.

¹⁰⁸ Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe çdo të bëhet?*, Tiranë: Mësonjëtorja, 1999, f. 12, 16-20, 84, etj.

Marrëveshja e dytë ishte një hap i rëndësishëm i Skënderbeut për të angazhuar fuqitë europiane në luftë kundër osmanëve, mbasi alarmoi si Papatin ashtu edhe Republikën e Venedikut. Kjo e fundit hyri në bisedime me Skënderbeun për krijimin e një aleance për luftë të përbashkët kundër shtetit osman. Pasi lidhi marrëveshje me Venedikun (1463) dhe kur pa se përgatitjet e kryqëzatës po shpejtoheshin, Skënderbeu denoncoi marrëveshjen e armëpushimit dhe filloi veprimet luftarake¹⁰⁹.

Meqenëse marrëveshja e parë u bë me kërkesën e sulltanit, H. Feraj e kritikon Skënderbeun që nuk pranoi pozitën e vasalitetit, e propozuar nga sulltani. Për rrjedhojë vendi do të kishte shpëtuar nga shkatërrimi i mëtejshëm¹¹⁰. Dihet se sulltani u dha mjaft sundimtarëve grekë, bullgarë, hungarezë e serbë pozitën e vasalitetit, por asnjëri nuk e gëzoi atë për shumë kohë, me përjashtim të tokave rumune, të cilat iu nënshtruan të parat dhe pa luftë.

Në kuadrin e zëvendësimit të përfaqësuesve të rrymës kryengritëse me ata të vasalitetit, H. Feraj ka bërë një ndarje që përsëri nuk përputhet me realitetin historik. E nisim nga Pjetër Bogdani. Sipas tij, është nxjerrë në plan të parë Pjetër Bogdani që bashkëpunoi me rusët e Arsenijen III (Cërnojeviç) dhe aleatët e tyre austro-hungarezë dhe janë lënë në plan të dytë klerikët katolikë që luftuan kundër sllavizimit të kishës shqiptare etj, etj¹¹¹.

Nxjerrja në plan të parë e tij nuk ka të bëjë fare se me kë bashkëpunoi, por me veprën e tij, si udhëheqës i një prej kryengritjeve më të mëdha çlirimtare të shek. XVII me një program me qëllime të caktuara autonomiste nën sundimin austriak. Madje vdekja e tij do të vlerësohet nga komanda e lartë austriake, si një nga shkaqet kryesore të rënies së kryengritjes në Shqipërinë e Veriut¹¹². Ai ishte shpirti i kryengritjes dhe ndërmjetësi kryesor me perandorin austriak. Historiografia jo vetëm ajo e periudhës së diktaturës komuniste, po edhe ajo e dhjetëvjeçarit të fundit e ka vlerësuar rolin e P.Bogdanit si një nga drejtuesit kryesorë të kësaj

¹⁰⁹ A. Luarasi, "Vështrim politik-juridik mbi disa traktate të Skënderbeut", në *Studime historike*, nr.1, Tiranë: 1982, f.69-70; P. Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f. 177.

¹¹⁰ H. Feraj, "Mbi debatin për Skënderbeun ...", në *Rimëkëmbja*, 25 janar 2000.

¹¹¹ Po aty.

¹¹² P. Thëngjilli, "Shqiptarët dhe luftat austro-osmane (1683-1699)", në *Studime Albanologjike*, nr. 1, Tiranë: 1999, viti IV (5), f. 54.

kryengritjeje. Ai nuk ishte i vetëm, por radhitej krahas Athanasit, patrikut të Ohrit nga Vlora; Nikolla Mejkashit, P.Budit, Mark Skurrës, të cilët nuk i pengoi petku fetar në realizimin e qëllimeve çlirimtare¹¹³.

Sipas H.Ferajt, Bushatllinj të kishin zhvilluar beteja fitimtare kundër serbëve dhe grekëve¹¹⁴. Nga Bushatllinj të autori veçon Mehmet pashë Plakun¹¹⁵, por nuk përmend as Karamahmutin, as Ibrahimin dhe as Mustafa pashën. Karamahmutin nuk e ka qejf se kërkonte t'i shëmbëllente Skënderbeut, se ai desh të krijonte Konfederatën Ilirike, ku të përfshinte shqiptarë dhe sllavë, se ai gjithmonë qëndroi në opozitë me pushtetin qendror osman dhe synonte të krijonte një shtet autonom shqiptar¹¹⁶. Në pamje të parë, sipas autorit kushtet e vasalitetit mund t'i përmbushte Ibrahimin, i cili mbajti një qëndrim krejt të kundërt nga ai kryengritës i Karamahmutit, aq sa në variantin e vitit 1965 të *Historisë së Shqipërisë* del si nëpunës i bindur, prandaj dhe arriti të bëhej vali i Rumelisë, si kundërpeshë e Ali Pashë Tepelenës¹¹⁷. Studiuesi S.N.Naçi në monografinë dyvëllimëshe, ka arritur në përfundimin se edhe Ibrahimin ndoqi të njëjtën platformë atë të autonomisë¹¹⁸. Mustafa pashë Shkodrani mori pjesë i detyruar nga pushteti qendror në fushatat kundër Ali Pashë Tepelenës dhe kundër Revolucionit Grek¹¹⁹.

Sipas H.Ferajt është glonorifikuar Ali Pashë Tepelena që ka qenë vegël e nacionalizmit grek¹²⁰. A mund të jetë vegël ai që shpejtoi fillimin e Revolucionit Grek? Aliu për të shpëtuar nga pozita kritike u përpoq të lidhej me të gjithë kundërshtarët e sulltanit, madje edhe me armiqtë e tij të dikurshëm. Ai e dinte se disa udhëheqës grekë ia kishin me të pabesë dhe e shfrytëzuan ndihmën e tij. Si mund të vlerësohet kjo figurë në këtë mënyrë kur burra shteti, si Napoleon Bonaparti, qeveria angleze, qeveria ruse, madje dhe vetë sulltani e respektonin Aliun për zgjuarsinë natyrale,

¹¹³ Më hollësisht shih P. Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, 2, f.133-140, 155, 192, 221 etj.

¹¹⁴ H. Feraj, "Mbi debatin për Skënderbeun ...", në *Rimëkëmbja*, shkurt 2000.

¹¹⁵ Po aty.

¹¹⁶ Petrika Thëngjilli, "Aftësia shetformuese e Karamahmut pashë Bushatit", kumtesë me rastin 205-vjetorit të rënies së Karamahmutit, botuar në gazetën *Drita e Dijes*, 30 tetor 2001 dhe në *Kumtarin e Muzeut të Shkodrës*.

¹¹⁷ *Historia e Shqipërisë*, vëll. I, Tiranë: 1959, f. 436.

¹¹⁸ Stavri N. Naçi, *Pashallëku i Shkodrës nën sundimin e Bushatllijve (1757-1796)*, Tiranë: 1964, f.138.

¹¹⁹ *Po aty*, f. 129-144.

¹²⁰ H. Feraj, "Mbi debatin për Skënderbeun ...", në *Rimëkëmbja*, shkurt 2000.

për diplomacinë e tij. Aliu gjithmonë foli në emër të shqiptarëve dhe të Shqipërisë. Jo rastësisht rilindasit e vendosnin mbas Pirros dhe Skënderbeut. I pari në Ballkan ai hodhi idenë e një shteti me kushtetutë. Në rast se Aliu do të gjente mbështetje tek faktori ndërkombëtar i krishterë, lëvizjet për formimin e shteteve kombëtare në Ballkan do të fillonin nga Shqipëria. Jo vetëm autorë shqiptarë, por edhe të huaj mendojnë se tek Aliu ndeshen elementë të nacionalizmit shqiptar*.

H. Feraj ankohet se është lavdëruar Çerçiz Topulli dhe Gjoleka dhe është lënë në plan të dytë Abedin Dino, që shpëtoi Çamërinë nga aneksimi grek. Pa u ndalur tek Çerçiz Topulli dhe Abedin Dino, po mjaftohem tek Zenel Gjoleka. Ai akuzohet për bashkëpunim me qeverinë greke. Nga asnjë autor shqiptar dhe i huaj që është marrë me vitet '20-60 të shek. XIX nuk është bërë një akuzë e tillë¹²¹. Në kuadrin e kryengritjeve gjatë periudhës së parë të Tanzimatit midis kryengritësve shqiptarë dhe qeverisë greke (1847) kishte përputhje interesash ndaj armikut të përbashkët, secili për interesat e veta. Ai u takua me përfaqësuesit e qeverisë greke, por kur kuptoi qëllimet aneksioniste të emisarit grek, i ndërpreu bisedimet¹²². Ai vdiq duke luftuar kundër forcave malazeze së bashku me forcat e tij dhe përkrah forcave osmane (1852). Duke u nisur nga ky fakt ai është kritikuar si vegël e osmanëve, prandaj autori duhej ta përfshinte tek vasalistët. Pjesa më e madhe e studiuesve mendojnë se ai shkoi të mbrojë territoret shqiptare nga qëllimet aneksioniste të qeverisë malazeze, prandaj nuk ka asnjë glorifikim të kësaj figure¹²³.

* Mendimet mbi Ali pashë Tepelenën do të kemi rastin t'i shprehim në një monografi më vete.

¹²¹ Ligor K. Mile, *Kryengritjet popullore në fillim të Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1830-1877)*, Tiranë: 1962; Shkëzen Raça, *Marrëdhëniet shqiptaro-greke (1829-1881)*, Prishtinë: 1990, f.55; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll.II, f. 96.

¹²² P.Thëngjilli, *Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit ...*, nr. 4, dorëshkrim, f.245.

¹²³ P.Thëngjilli, *Historia e popullit shqiptar ...*, f.414.